BASHKI të FORTA

Smart Processes



# PLANI I PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR

## *BASHKIA MIRDITË*

# Përmbajtja

1. Hyrje ... 4
1.1 Qëllimi ... 4
1.2 Shtrirja ... 5
1.3 Vizioni ... 5
1.4 Misioni ... 5
1.5 Objektivat ... 5
1.6 Përgjegjësit ... 6
2. Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit ... 7
*2.1 Qëllimi* ... 7
*2.2 Objektiva të përgjithshëm* ... 7
2.3 Regjistrimi i fëmijëve ... 7
2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopësht ... 7
2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor ... 26
2.4.1 Këshilli i Prindërve ... 26
2.4.2 Bordi i Kopshtit ... 36
2.4.3 Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit ... 45
3. Proceset Kryesore - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit ... 51
*3.1 Qëllimi* ... 51
*3.2 Objektiva të përgjithshëm* ... 51
3.3 Përfshirja sociale ... 51
3.3.1 Identifikimi i nevojave për përfshirje ... 51
*Lista e projekteve* ... 52
3.3.2 Ndihma e përditshme ... 59
3.4 Mbrojtja e fëmijëve ... 62
3.4.1 Identifikimi i abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës ... 62
3.4.2 Shërbimi bashkiak i mbrojtjes së fëmijës ... 71
3.5 Fëmijët me aftësi të kufizuar ... 75
3.5.1 Adresimi i prindërve ... 75
3.5.2 Kërkesa për fonde shtesë ... 79
3.5.3 Ndihma e përditshme ... 82

4. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit ................................. 86
*4.1 Qëllimi*.................................................................................................................. 86
*4.2 Objektiva të përgjithshëm* .................................................................................... 86
4.3 Burimet Njerëzore.................................................................................................. 86
4.3.1 Rekrutimi i stafit ............................................................................................... 86
4.3.2 Trajnimi i stafit ................................................................................................. 90
4.4 Menaxhimi i godinave ............................................................................................ 95
4.4.1 Rikonstruksioni i objekteve .............................................................................. 95
4.5 Materialet ............................................................................................................... 101
4.5.1 Planifikimi i nevojës për materiale ................................................................... 101
4.6 Ushqimi.................................................................................................................. 105
4.6.1 Planifikimi i dietës dhe menysë ........................................................................ 105
5. Buxheti.................................................................................................................... 108

# 1. Hyrje

Në Shqipëri në vazhdën e ndryshimeve politike, në vitin 2015, u përfshinë edhe ndryshimet që lidheshin në mënyrë të drejpërdrejtë me mënyrën e organizimit të Bashkive në Republikën e Shqipërisë. Si rezultat u krijuan 61 Bashki, të cilat përballen me ndryshime të shumta organizative dhe administrative. Në këtë Kuadër për shkak të decentralizimit Bashkive ju shtohen disa detyra, si dhe nevoja për t'ju përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqënie sociale dhe ekonomike.

Ndërkohë në bazë të ligjit 69/2018 të ndryshuar për Arsimin, bashkisë i kalon nën juridiksionin e saj çdo çështje që lidhet ngushtë me mbarëvajtjen e arsimit parashkollor. Në këtë kuadër Bashkia Mirditë harton këtë plan strategjik, asistuar nga projekti Bashki të Forta.

Qëllimi i këtij plani është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e Arsimit parshkollor. Arsimi, konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Mirditë. Plani i përmirësimit synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa objektiva strategjik.

## 1.1 Qëllimi

Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Mirditë dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjjitha proceset që lidhen me arsimin parashkollor. Konkretisht nëpërmjet planit synohet:

- Përmirësimi i shërbimit në kopshtet ku mungojnë regjistrimet në mënyrë që të rriten regjistrimet;
- Planifikim strategjik përsa i përket riorganizimt të infrastrukturës së kopshtit, me qëllim përsimirësimin e shërbimit në kopshtet që janë brenda shkollave, ose kopshteve që kanë nevojë imediate për restaurim;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore të bashkisë në çështje të arsimit parashkollor, përmes ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e drejtimit dhe administratës së bashkisë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të përmirësimit;
- Ngritja e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të Arsimit Parashkollor, sipas të cilëstë sigurohet respektimi i kërkesave ligjore dhe kuadrit të brendshëm rregullator nga zyrtarët vendorë (autoritetet dhe administrata) si edhe përmirësimin dhe forcimin e këtij kuadri për të parandaluar dhe eliminuar shkeljet;
- Bashkëpunimi i ngushtë me prindërit dhe komunitetin, për të ndërgjegjësuar për rëndësinë që ka kopshti në zhvillimin e fëmijës;

Në pjesën e parë të dokumentit gjendet një analizë përmbajtësore e cila do të përmbajë Vizionin, Misionin, Objektivat Strategjike të Planit, personat përgjegjës për implementimin, monitorimin dhe zhvillimin e tij.

Në pjesën e dytë dokumenti fokusohet në vendosjen e Objektivave të përgjithshëm dhe specifik për secilin proces. Për të lehtësuar procesin e implementimit të planit, janë vendosur edhe

indikatorët e performancës si dhe objektivat specifik për secilin kriter të përgjithshëm dhe më pas aktivitetet që duhen ndërmarrë për të arritur objektivat e vendosur.

Ndërkohë në pjesën e tretë është përmbledhur buxheti i nevojshëm për të realizuar ndërhyrjet në terren me qëllim rritjen e cilësisë në arsimin parashkollor.

## 1.2 Shtrirja

Plani synon të përmirësojë shërbimin e Arsimit Parashkollor në Bashkinë e Mirditës. Plani do të implementohet në të gjitha kopshtet që ka nën juridikson Bashkia Mirditë. Për mbarëvajtjen e aktiviteteve në plan dhe monitorimin e tij do të kujdeset Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës.

## 1.3 Vizioni

Përmirësimi i shërbimit të Arsimit Parashkollor, nëpërmjet ngritjes së strukturave për arsimin parashkollor, dhe fuqizimin e tyre për t'ju përgjigjur nevojave të fëmijëve.

## 1.4 Misioni

Fuqizimi dhe prioritizimi i arsimit parashkollor, si çelësi kryesor i zhvillimit të suksesshëm të brezave të ardhshëm.

## 1.5 Objektivat

- Fuqizimi i Sektorit të Arsimit pranë Bashkisë Mirditë;
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimit në kopshte nëpërmjet organizimit të regjistrimeve sipas vendbanimeve;
- Përmirësimi i infrastrukturës së kopshteve;
- Ulja e numrit të grupeve të përziera në kopshte nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës;
- Ngritja dhe fuqizimi i strukturave mbështetëse të kopshtit (Bordi dhe Këshilli i Prindërve, Komisionii Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit;
- Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe shërbimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, me aftësi të kufizuar dhe në nevojë për përfshirje sociale.

## 1.6 Përgjegjësit

1. Koordinator i planit:
   - Personi përgjegjës për Njësinë e Arsimit Parashkollor, i cili kujdeset për zbatimin e planit nga të gjithë aktorët përgjegjës;
   - Personi përgjegjës për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale.
2. Aktorët zbatues të planit:
   - Drejtues kopshti;
   - Mësues i kopshtit;
   - Komuniteti;
   - PMF;
   - Psikologu;
   - GTN;
   - Grupet e terrenit.
3. Monitorues/vlerësues i planit:
   - Kryetari i Bashkisë;
   - Këshilli i Bashkisë.

# 2. Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

## *2.1 Qëllimi*

Proceset e menaxhimit nuk janë pjesë e ekzekutimit të menjëhershëm të detyrave, por vendosin objektiva strategjike dhe kushte kuadër që ndikojnë në llojet e tjera të procesit. Këto përfshijnë planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë.

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetet në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 3-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit. Kjo përbën planifikimin e kërkesës së arsimit parashkollor, duke marrë parasysh që arsimi parashkollor nuk është i detyrueshëm në Shqipëri.

Procesi i parashikimit ka gjithashtu edhe dimensionin e ofertës, që përfshin vlerësimin e numrit të mësuesve të nevojshëm, drejtorëve, mësuesve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara, stafit mbështetës, si dhe objekteve (mjediseve), stafit shtesë etj.

Plani i përmirësimit të shërbimit në Proceset e Menaxhimit ka si qëllim përmirësimin e shërbimit të kopshtit duke siguruar ulje të numrit të fëmijëve në kopshtet e mbipopulluara; rritje të regjistrimeve në kopshtet nën kapacitet; ulje të numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në to, dhe themelimin dhe fuqizimin e organizmave brenda institucionit të kopshtit.

## *2.2 Objektiva të përgjithshëm*

Objektivat kryesorë të këtij plani në lidhje me Proceset e Menaxhimit janë:

1. Planifikimi dhe parashikimi bazuar në të dhëna të sakta dhe të unifikuara mes institucioneve të ndryshme në lidhje me arsimin parashkollor;
2. Rritja e regjistrimeve në kopshtet nën kapacitet, veçanërisht në kopshtet e NJA, nëpërmjet aktiviteteve të organizuara nga kopshtet;
3. Themelimi dhe fuqizimi i organizmave të kopshteve në çdo kopësht të Bashkisë Mirditë.

## 2.3 Regjistrimi i fëmijëve

### 2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopësht

*Informacion i përgjithshëm*

Duke u bazuar në aktet ligjore si dhe numrin e regjistrimeve në kopshtet publike në territorin e Bashkisë Mirditë vihet re që se në Kopshtet e Bashkisë Mirditë nuk ka mbipopullim. Nga analiza evidentoet se 80% shfrytëzohen kapacitetet akomoduese të kopshteve në total, duke u bazuar në numrin e fëmijëve të regjistruar.

Përsa i përket kapacitetit akomodues që kanë kopshtet publike, rezulton se kapaciteti akomodues i kopshteve publike është më i madh se numri i fëmijëve të regjistruar në to.

Ndërkohë një faktor që duhet të shikohet me prioritet nëse bazohemi tek "***Standardet të Zhvillimit dhe të të nxënit''***, fëmijët ndahen në tre grupe. Ndarja në grupe bëhet sipas moshës së fëmijës, pasi zhvillimi i tyre është i ndryshëm në grupmosha të ndryshme. Ndërkohë, në disa kopshte vihet re:

- Ekzistenca e numrit të lartë të grupeve të përziera me mosha të ndryshme fëmijësh kryesisht në zonat rurale, gjë që ndikon negativisht në zhvillimin e fëmijëve. Bazuar në Vendimin Nr. 159, kopshtet duhet të jenë godina më vete, për të ofruar sigurinë e fëmijëve.
- Grupet e para dhe të dyta mbizotërojnë vetëm në zonat urbane. Përkatësisht, në Njësitë Administrative Rrëshen dhe Rubik kemi një mbizotërim të grupeve të para, grupeve të dyta dhe grupeve të treta papërgatitore. Duhet marrë në konsideratë që në këtë grupmoshë, fëmijët përgatiten për të shkuar në parashkollor. Të dhënat mbi numrin e fëmijëve në moshë kopshti pranë çdo NJA, do na lejnonin të bënim analiza më konkrete për të kuptuar sa fëmijë 3&4 vjeç kemi dhe sa janë të regjistruar. Gjithashtu, është e rëndësishme të realizohen takime me prindërit për të kuptuar më mirë pse prindërit nuk dërgojnë fëmijët në kopsht në grupin e parë dhe të dytë.

Gjithashtu, ka mosdakordim të shifrave përsa i përket normës për numrin e nxënësve në çdo grup të kopshtit ndërmjet udhëzimit Nr.14, datë 10.07.2023, dhe vendimit Nr.159, datë 1.3.2017. Sipas udhëzimit **Nr. 14/pika 1**: grupet e veçanta të nxënësve në kopshtet me ushqim në zonat urbane të formohen me jo më pak se 25 nxënës që frekuentojë. **Pika 2/:** grupet grupet e veçanta të nxënësve në kopshtet me ushqim në zonat rurale të formohen me jo më pak se 15 nxënës që frekuentojë. **Pika 3/:** Grupet e përziera të nxënësve në zonat rurale të formohen me jo më pak se 10 nxënës që frekuentojnë. Në rastet kur ky numër nxënësish nuk sigurohet me miratimin të njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të formohet grup me jo më pak se 5 nxënës që frekuentojnë.

Ndërkohë sipas **vendimit Nr.159, datë 1.3.2017**'Për miratimin e standardeve të projektimit të kopshteve', numri i fëmijëve në grupe duhet të jetë;

Grupi 1: deri në15 fëmijë.

Grupi 2: deri në 25 fëmijë.

Grupi 3: deri në 30 fëmijë.

*Objektiva kryesore:*

Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së tyre të banimit për të siguruar shpërndarje të barabartë të fëmijëve në kopshte, bazuar në kapacitetin pritës të kopshteve.

*Nën-objektivat:*

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti në Bashkinë e Mirditës |
| 2 | Unifikimi i të dhënave të arsimit parashkollor mes Bashkisë, ZVAP, NJA dhe kopshteve |
| 3 | Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit në aktivitete të organizuara nga kopshtet |
| 4 | Shpërndarje e njëtrajtshme e fëmijëve ndërmjet kopshteve |

*Indikatorët e performancës*

*Lista e Aksioneve*

| Numri | Projekti | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxhet Vit 2024 | Buxhet Vit 2025 | Buxhet Vit 2026 | Total periudhe |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 005 | Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo Kopësht | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 1500 lekë/person | 1500 lekë/person | 1500 lekë/person | 4500 lekë/person |
| 004 | Organizimi i i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 003 | Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| Numri | Projekti | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxhet Vit 2024 | Buxhet Vit 2025 | Buxhet Vit 2026 | Total periudhe |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe Kulturës | | | | | |
| 002 | Krijimi i një regjistri i cili përmban të dhëna analitike për kopshtin | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 001 | Identifikimi i i fëmijëve në moshë kopshti | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |

*Lista e projekteve*

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 001 | **Projekti**: Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës në Bashkinë e Mirditës nuk ka një listë të plotë të fëmijëve në moshë kopshti. Si pasojë, nuk mund të bëjë parashikime dhe të planifikojë saktësisht mbulimin me shërbim të kopshtit. | | |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje | | |
| Duke mos pasur një numër të fëmijëve në moshë kopshti, nuk është e qartë norma e regjistrimit të fëmijëve në kopsht. Regjistrimi dhe frekuentimi në kopsht nuk janë të detyrueshëm, | | |

megjithatë arsimi parashkollor është shumë i rëndësishëm për formimin e fëmijëve. Aktualisht, është e vështirë të llogaritet norma e regjistrimit dhe të punohet për të rritur atë.

Për shkak të numrit të vogël të fëmijëve të regjistruar në kopshtet e Njësive Administrative, formohen grupet e përziera. Aktualisht, numri i grupeve të përziera është më i lartë se numri i grupeve të I, II dhe III në Njësitë Administrative si Selitë, Kthellë, Fan, Orosh, Kaçinar. Ndëtkohë në njësitë Rrëshen dhe Rubik numrin më të lartë të grupeve, e zënë grupetn e para të dyta dhe të treta duke qenë edhe zona urbane dhe numri i fëmijëve është më i madh. Për shkak të mungesës së numrit të fëmijëve në moshë kopshti në Bashkinë e Mirditës, nuk mund të kuptohet qartë se si mund të zgjidhet problemi i grupeve të përziera. Nuk është e qartë nëse numri i ulët i regjistrimeve vjen si arsye e numrit të ulët të fëmijëve, apo janë arsye të tjera si infrastruktura e kopshtit dhe konceptimi i arsimit parashkollor si jo i rëndësishëm për fëmijët. Për këtë arsye, është e vështirë të hartohet zgjidhja e duhur e këtij problemi.

**ii Synimi i projektit**

Një mënyrë për identifikimin e fëmijëve në moshë kopshti në Bashki është duke bashkëpunuar me Zyrën e Gjendjes Civile dhe Qendrat Shëndetësore. Bashkëpunimi me Zyrën e Gjendjes Civile do të mundësojë listën e fëmijëve të regjistruar në Gjendje Civile të moshës 3-5 vjeç sipas vendbanimit çdo vit. Nga Qendrat Shëndetësore mund të merren listat e fëmijëve të vaksinuar të moshës 3-5 vjeç sipas vendbanimit çdo vit. Nëpërmjet këtij projekti synohet që:

1. Rritja e regjistrimit dhe frekuentimit të kopshtit nga fëmijët. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës, pas përfundimit të regjistrimit të fëmijëve, mund të identifikojë fëmijët në moshë kopshti që nuk janë regjistruar. Në këtë mënyrë, drejtorët dhe mësueset e kopshteve mund të kryejnë takime me prindërit për të kuptuar arsyet e mos regjistrimit të fëmijëve të tyre në kopsht dhe informimin mbi rëndësinë e arsimit parashkollor të fëmijëve. Në këtë mënyrë, synohet të rritet numri i fëmijëve që regjistrohen dhe ndjekin kopshtin.
2. Ulja e grupeve të përziera dhe e numrit të fëmijëve në grupet e përziera. Me rritjen e regjistrimit mund të ulet dhe numri i fëmijëve në grupet e përziera. Duke qenë se ato formohet kur numri i fëmijëve për të formuar grup të I, II dhe III nuk është i mjaftueshëm, rritja e normës së regjistrimit do të mundësojë zvogëlimin e numrit të grupeve të përziera dhe numrin e fëmijëve në këto grupe.
3. Lehtësim i procesit të regjistrimit të fëmijëve në kopsht sipas zonës së banimit. Duke pasur listat e fëmijëve në moshë kopshti sipas vendbanimit dhe moshës, Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës mund ta ketë më të lehtë të marrë vendimin për regjistrimin ose jo të fëmijëve në kopshtet ku kanë aplikuar.

**iii Niveli i ndërhyrjes**
**A: Ligjore**

| |
|---|
| 1. Përcaktimi i marrëveshjes së bashkëpunimit për dërgimin e listave të fëmijëve në moshë kopshti mes:<br><br>a) Bashkisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,<br>b) Bashkisë dhe Qendrave Shëndetësore.<br><br>Marrëveshja do të përmbajë karakteristikat e listës që nevojitet (emri i fëmijëve, ditëlindja, vendbanimi), afatet e përgatitjes dhe dërgimit të saj, zyra/personi përgjegjës i secilit institucion për mbulimin e detyrimeve sipas marrëveshjes dhe mënyrën e dërgimit të listave.<br><br>**B: Menaxheriale**<br><br>1. Përcaktimi i një personi/zyre përgjegjëse nga secili institucion për dërgimin/marrjen e listave sipas rregullave të marrëveshjes së firmosur. |
| **iv Aktivitetet kryesore të projektit**<br><br>1. Kryerja e takimeve mes aktorëve për theksimin e nevojës për identifikimin e fëmijëve në moshë kopshti; propozimin për bashkëpunim dhe identifikimi i problematikave (nëse ka) në realizimin e bashkëpunimit dhe gjetja e zgjidhjeve. Do të kryhen 2 takime:<br>   1. Takim me përfaqësues të Bashkisë dhe Njësisë së Arsimit Parashkollor, Gjendjes Civile në Mirditë dhe përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;<br>   2. Takim me përfaqësues të Qendrave Shëndetësore dhe Njësisë së Arsimit Parashkollor;<br>2. Hartimi dhe firmosja e marrëveshjes mes Bashkisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Bashkisë dhe Qendrave Shëndetësore;<br>3. Zbatimi i marrëveshjes. Marrja e listave nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës dhe hartimi i një liste të unifikuar të fëmijëve në moshë kopshti. |
| **b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**<br><br>1. Listë vjetore të fëmijëve në moshë kopshti;<br>2. Lehtësim i procesit të regjistrimit të fëmijëve sipas zonave të banimit;<br>3. Rritja e normës së regjistrimit të fëmijëve në kopsht;<br>4. Mundësia e uljes së grupeve të përziera dhe numrit të fëmijëve në këto grupe. |

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)<br><br>• Qendra Shëndetësore, |
|---|---|

| | |
|---|---|
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | • Gjendja Civile. |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kryerja e takimeve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Hartimi dhe firmosja e marrëveshjes | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Zbatimi i marrëveshjes | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:** 2024 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:** Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 002 | **Projekti**: Krijimi i një regjistri cili përmban të dhëna analitike për kopshtin | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |

**a)Përshkrim i shkurtër i projektit**

**i Situata**

Në Bashkinë Mirditë kemi një mungesë të një databaze me të dhëna për kopshtet. Të dhëna këto, që janë shumë të nevojshme për analizimin e situatës në kopshte dhe parashikimin e ardhshëm të gjendjes së tyre, që kanë të bëjnë jo vetëm me regjistrimin dhe trendin e regjistrimeve në të ardhmen por edhe me elementë të tjerë që lidhen me aspekte të ndryshme të funksionimit të kopshteve.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Të dhëna si numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte, numri i mësuesve, numri i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale (me disavantazh social), kapaciteti akomodues i kopshteve, godina, funksionalitetet, ushqimi, rikonstruksioni, mirëmbajtja etj janë të dhëna të nevojshme për ti patur

të përfshira në një regjistër i cili mund të rifreskohet vit pas viti me të dhëna të tjera që do të vijnë në ndihmë lidhur me planifikime apo ndërhyrje për kopshtet në të gjithë territorin e Bashkisë. Mosrakordimi i të dhënave vështirëson diagnostikimin e situatës, evidentimin e problemeve dhe shkaqeve të tyre dhe evidentimin e nevojës për ndërhyrje ose ndryshime në kopshte, ndaj organizimi i tyre në një regjistër do të lehtësonte punën.

Shpeshherë janë vënë re mosrakordime në të dhëna pasi vetë mbledhja e këtyre të dhënave ka ardhur nga institucione të ndryshme dhe nuk kanë qenë të unifikuara në këtë Bashki. Duke mos pasur një databazë të unifkuar të të dhënave mes institucioneve, nuk është e qartë se si është realisht situata në kopshte. Problematika reale është e vështirë të identifikohet menjëherë dhe si pasojë edhe zgjidhjet për të do të vonohen të zbatohen.

Është e nevojshme të krijohet një sistem i unifikuar i të dhënave në kohë reale, në mënyrë që të dhënat të jenë të sakta, të gjithë aktorët të kenë akses te këto të dhëna dhe ndryshimi i tyre të jetë i menjëhershëm, pa kosto dhe njëkohësisht te të gjitha databazat e aktorëve. Në këtë mënyrë, Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës dhe ZVAP do të mund të bëjnë parashikimet dhe planifikimet e nevojshme për ofrimin e një shërbimi efikas.

**ii Synimi i projektit**

Një mënyrë për të pasur një unifikim të të dhënave në kohë reale është krijimi i një Platforme Digjitale e cila përmban të dhëna analitike për kopshtin.

Në këtë platformë mund të kenë akses:

- Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës mund të ketë akses te të gjitha të dhënat për çdo kopsht dhe është përgegjëse për plotësimin e tyre.
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit mund të ketë akses në seksionin e gjendjes fizike të ndërtesave të kopshteve, për të plotësuar të dhënat për çdo kopsht, pas vlerësimit të kryer çdo vit.
- Drejtoria e Shërbimit Social për të plotësuar të dhënat për fëmijët në nevojë për mbrojtje, në nevojë për përfshirje sociale dhe me aftësi të kufizuar.

Nëpërmjet këtij projekti synohet rakordimi i të dhënave dhe koordinimi mes Bashkisë, Njësive Administrative, ZVAP dhe kopshteve dhe lehtësimi i procesit të vlerësimit të nevojave që ka çdo kopsht. Në këtë mënyrë do të bëhet e mundur që situata e arsimit parashkollor të jetë e qartë.

Struktura e Regjistrit do të përmbajë:

1. Seksionin e të dhënave të përgjithshme (emri i kopshtit, njësia administrative, adresa, nëse kopshti është publik ose privat, me ushqim ose pa ushqim, në godinë më vete ose jo, emri dhe kontaktet e drejtuesit, etj.)
2. Seksioni i të dhënave të fëmijëve (numri i fëmijëve të regjistruar sipas moshës, gjinisë dhe grupit ku bëjnë pjesë, numri i grupeve sipas llojeve, numri i fëmijëve në çdo grup, frekuentimi çdo muaj, etj.)

3. Seksioni i të dhënave mbi organizmat që funksionojnë brenda kopshtit (Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit dhe Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit).
4. Seksioni i të dhënave të inventarit të kopshtit (numri i mobilieve, viti i blerjes, gjendja e tyre, materialet didaktike dhe kancelarike, etj.)
5. Seksioni i Shërbimeve Sociale (numri i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale dhe aftësi të kufizuar sipas vendbanimit/kopshtit, moshës, gjinisë, etj).
6. Seksioni i gjendjes fizike të godinës së kopshtit (nevojat për mirëmbajtje dhe rikonstruksion sipas prioritetit të ndërhyrjes, furnizimi me ujë, elektricitet, internet dhe ngrohje, numri i hapësirave, sipërfaqja e secilës prej hapësirave, etj.)
7. Seksioni i Burimeve Njerëzore (numri i mësueseve, mësueseve ndihmëse, stafit mbështetës, përvoja në punë, mosha dhe gjinia, etj.)

Nëpërmjetregjistrit mund të gjenerohen edhe analizat e situatës nga të dhënat e plotësuara. Për shembull, mund të llogaritet kapaciteti akomodues i kopshteve (duke marrë si referencë hapësirat në m2 të kopshteve, numrin e klasave, etj). Gjithashtu, mund të llogaritet numri i fëmijëve për një mësuese, norma e frekuentimit, norma e regjistrimit të fëmijëve, numri i karrigeve për 1 tavolinë, numri i shtretërve, numri i fëmijëve që flenë në kopsht dhe kërkesa për mobilje të reja në secilin prej kopshteve. Kështu, Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës do të ketë të qartë situatën e kopshteve dhe nevojës për ndërhyrje.

**iii Niveli i ndërhyrjes**

**A: Ligjore**

1. Hartimi i një rregullore për mënyrën e plotësimit të Regjistrit në Excel, institucionet që kanë akses, afatet e plotësimit ose të dërgimit të të dhënave te Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës, etj.
2. Hartimi i një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë dhe ZVAP mbi raportimin e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte për të shmangur raportimin direkt të kopshteve pranë ZVAP dhe si rrjedhim mosrakordimin e shifrave.

**B: Menaxheriale**

1. Dërgimi i informacioneve të detajuara drejt Njësisë së Arsimit Parashkollor nga kopshtet sipas procedurave të përcaktuara në rregullore.
2. Plotësimi i të dhënave nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
3. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit kryen vlerësimin e ndërtesave të kopshteve çdo vit nëpërmjet vizitave në terren. Vlerësimi fillon në muajin Mars të çdo viti dhe përfundon në muajin Prill. Të dhënat e mbledhura nga inspektimet hidhen në Regjistër brenda muajit Maj.
4. Gjenerimi i analizave të situatës së kopshteve dhe planifikimi i ndërhyrjes në nivel kopshti nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës.

5. Dërgimi i të dhënave te ZVAP dhe Njësitë Administrative.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Krijimi i një regjistri në Excel Krijimi i një regjistri elektronik të thjeshtë nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës në Bashki.
2. Trajnimi i punonjësve që do të hedhin të dhëna ose do të gjenerojnë analiza.
3. Njohja e punonjësve me detyrimet e tyre në respektimin e afateve të plotësimit të të dhënave dhe gjenerimit të analizave. Stafi i kopshteve, Njësisë së Arsimit Parashkollor, Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtorisë së Shërbimit Social njihet me rregulloren.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Regjistërme të dhënat individuale të kopshteve të plotësuara në kohë reale
2. Analiza e Situatës së kopshteve dhe planifikimi i ndërhyrjeve
3. Zgjidhja e problemeve në kohë reale

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
- Njësia e Prokurimit Publik

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- ZVAP;
- Njësitë Administrative;

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Krijimi dhe mirëmbajtje e Platformës Digjitale | Agjencia e Arsimit Sportit dhe Ndimes Sociale | | 0 | 110 000 | 30 000 | 140 000 |
| 2 | Trajnimi i punonjësve që do të hedhin të dhëna ose do të | Operatori ekonomik/Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe | | 0 | 50000 | 50000 | 100 000 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | gjenerojnë analiza | Kulturës | | | | | |
| 3 | Njohja e punonjësve me detyrimet e tyre në respektimin e afateve të plotësimit të të dhënave dhe gjenerimit të analizave | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2024 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 003 | **Projekti**: Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit | **Programi Buxhetor**: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |

**a)Përshkrim i shkurtër i projektit**

**i Situata**

Shpërndarja jo e barabartë e fëmijëve në kopshte vjen si pasojë e infrastrukturës së kopshtit dhe largësisë nga qendra e qytetit. Për këtë arsye, prindërit nuk i regjistrojnë fëmijët në kopshtet që u përkasin sipas zonës së banimit. Nga ana tjetër disa prindër, preferojnë ti regjistrojnë fëmijët e tyre në zonat ku ata janë të punësuar duke i pasur kështu më pranë vetes. Kjo situatë, vihet re kryesisht në kopshtet e qytetit ndërkohë, në kopshtet pranë zonave rurale nuk jemi në këto kushte, duke bërë kështu që kopshtet të jenë të nënpopulluara. Fakti që i vetmi kopësht me ushqim ndodhet në Bashkinë qendër, bën që prindërit ti regjistrojnë fëmijët e tyre në këtë kopësht edhe pse mund të mos i pëkasin asaj zone me çertifikatë banimi

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Shpërndarja jo e barabartë e fëmijëve në kopshte shkakton mbipopullim të disa kopshteve dhe nënpopullim të kopshteve të tjera. Mbipopullimi i kopshteve shkakton pengesa në procesin e edukimit dhe menaxhimit të fëmijëve, ndërsa nënpopullimi bën që hapësirat, në të cilat është investuar dhe janë në gjendje shumë të mirë, të mos shfrytëzohen maksimalisht.

**ii Synimi i projektit**

Për të siguruar shpërndarjen e barabartë të fëmijëve në kopshte është e rëndësishme të sigurohet që cilësia e shërbimit tek të gjithë kopshtet është e njejtë dhe regjistrimi kryhet sipas zonës së banimit dhe jo preferencave të prindërve. Ky projekt përqendrohet në realizimin e regjistrimit të fëmijëve në kopsht sipas zonës së banimit nëpërmjet përcaktimit të një rregulloreje, e cila do të ndiqet nga të gjitha kopshtet.

**iii Niveli i ndërhyrjes**
**A: Ligjore**

1. Urdhër nga Kryetari i Bashkisë për regjistrimin e fëmijëve në kopshtet pranë zonës së tyre të banimit;
2. Hartimi i një rregulloreje që përcakton procedurën, aktorët përgjegjës, afatet kohore dhe mënyrën e ndërveprimit ndërmjet palëve gjatë procesit të regjistrimit të fëmijëve në kopshte nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës.

**B: Menaxheriale**

Një model i rregullores mund të jetë si më poshtë:

1. Prindërit përpos dokumentave që dorëzojnë për regjistrimin e fëmijëve në kopsht, duhet të dorëzojnë dhe Certifikatën e vendbanimit. Afati i dorëzimit të dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e fëmijëve është 1 - 10 qershor;
2. Kopshti merr dokumentet e dorëzuara nga prindërit për çdo fëmijë dhe ia dërgon Njësisë së Arsimit Parashkollor. Dokumentet për çdo fëmijë mund të dërgohen nga kopshti deri në 2 ditë pas mbylljes së afatit të aplikimit;
3. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës merr vendimin bazuar në dokumentet e secilit prej fëmijëve dhe listën që disponon me fëmijët në moshë kopshti dhe i dërgon kopshteve listën e fëmijëve të regjistruar dhe listën e fëmijëve që nuk u është pranuar aplikimi së bashku me arsyet. Afati për marrjen e vendimit është deri në fund të qershorit. Gjithashtu, identifikon nëpërmjet listës së fëmijëve në moshë kopshti, fëmijët që nuk janë regjistruar ende në kopsht;
4. Në rastin kur një aplikim për regjistrim refuzohet, prindërit njoftohen nga drejtuesi i kopshtit mbi arsyet pse është refuzuar aplikimi dhe i sugjeron kopshtin në të cilin fëmijës i takon të regjistrohet;
5. Pasi regjistrimet përfundojnë, sipas udhëzimeve të Njësisë së Arsimit Parashkollor, drejtuesit/mësuesit e kopshteve mund të takojnë prindërit të cilët nuk kanë regjistruar ende fëmijët, për të identifikuar arsyet e mos regjistrimit dhe informuar prindërit mbi rëndësinë e arsimit parashkollor te fëmija. Kjo detyrë mund t'i përcaktohet dhe një punonjësi tjetër, si përshembull grupeve të terrenit që kanë si detyrë identifikimin e fëmijëve në situatë rruge.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Nxjerrja e Urdhërit nga Kryetari i Bashkisë për regjistrimin sipas zonës së banimit;
2. Hartimi i rregullores mbi procedurën e regjistrimit;
3. Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit;
4. Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht;
5. Takime me prindërit për regjistrimin e fëmijëve.
6. Formalizimi i rasteve të regjistrimit të fëmijëve që nuk i përkasin atij vendbanimi.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit;
2. Shpërndarje e njejtë e regjistrimit të fëmijëve;
3. Rritje e numrit të regjistrimeve.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës
- Kryetari i Bashkisë

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Nxjerrja e Urdhërit nga Kryetari i Bashkisë për regjistrimin sipas zonës së banimit | Kryetari i Bashkisë | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Hartimi i rregullores mbi procedurat e regjistrimit | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kulturës | | | | | |
| 4 | Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Takimi me prindërit për regjistrimin e fëmijëve | Drejtues/mësues i kopshtit | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2024 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 004 | **Projekti**: Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Përfshirja e komunitetit në vendimmarrje ose aktivitete që lidhen me Arsimin Parashkollor është e ulët. Në Njësitë Administrative numri i fëmijëve të regjistruar është i ulët. Ky fakt mund të vijë si pasojë e infrastrukturës së kopshteve dhe/ose mentalitetit të prindërve mbi arsimin parashkollor si një faktor jo i rëndësishëm në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve. | | |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje | | |
| Mospërfshirja e komunitetit në aktivitete ose çështje të rëndësishme të arsimit parashkollor është një tregues i mungesës së interesit të komunitetit për këto çështje, duke i konsideruar si çështje të një rëndësie jo shumë të madhe. Ky mentalitet mund të jetë një arsye e numrit të ulët të regjistrimit të fëmijëve në kopësht në Njësitë Administrative. Gjithashtu, nëse arsimi parashkollor nuk konsiderohet si prioritet nga komuniteti, atëherë mund të ndodhë të mos jetë një prioritet për vetë Bashkinë.<br><br>Për shkak të numrit të vogël të fëmijëve të regjistruar në kopshtet e Njësive Administrative, formohen grupet e përziera. Aktualisht, numri i grupeve të përziera është më i lartë se numri i | | |

grupeve të I, II dhe III dhe numri i fëmijëve në këto grupe është i lartë. Ky fakt shkakton vështirësi në edukimin dhe menaxhimin e fëmijëve.

Gjithashtu, për shkak të çështjeve dhe problemeve më madhore të Bashkisë dhe fokusit të saj te Programe Strategjike të Buxhetit, problemet e kopshteve gjatë hartimit të buxhetit mund të mos adresohen ashtu siç duhet dhe për pasojë buxheti i vendosur për arsimin parashkollor mund të mos jetë i mjaftueshëm për zgjidhjen e problemeve si rikonstruksioni i kopshteve apo ndërtimi i kopshteve të reja.

**ii Synimi i projektit**

Një mënyrë për të zgjidhur këtë çështje është përfshirja e komunitetit në aktivitete të organizuara nga kopshtet. Në këtë mënyrë, pritet të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit (përfshirë prindërit) për rëndësinë e arsimit parashkollor në formimin e fëmijëve dhe si pasojë pritet të rritet pjesëmarrja aktive në vendimmarrje, lobimi dhe theksimi i çështjeve që kanë nevojë të theksohen përsa i përket arsimit parashkollor.

Nëpërmjet aktiviteteve të iniciuara nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës dhe vënia në zbatim nga drejtuesit dhe mësuesit e kopshteve, synohet:

1. **Zhvillimi i fëmijëve.** Në këto aktivitete, protagonistët kryesorë do të jenë fëmijët, duke recituar, treguar përralla, kërcyer, etj. Në këtë mënyrë, aftësitë e fëmijëve për të bashkëpunuar dhe mësuar gjëra të reja do të rriten;
2. **Informimi i komunitetit.** Këto aktivitete është mirë që të ndërthuren dhe me sesione të shkurtra informuese për rëndësinë që ka arsimi parashkollor te formimi i fëmijëve ose të jenë kryesisht me natyrë informuese. Përveç aktivizimit të fëmijëve, komuniteti do të njihet, nëpërmjet mësueseve, edhe me faktin se sa i rëndësishëm është arsimi dhe nevojën që ekziston që ky komunitet të jetë më aktiv në çështje të arsimit parashkollor. Në këtë mënyrë, mund të lobohet prej tyre gjatë hartimit të buxhetit në Bashki për të rritur buxhetin e vendosur për kopshtet;
3. **Rritja e regjistrimeve.** Shumë prindër, duke e konsideruar kopshtin si një nivel jo të rëndësishëm të arsimit nuk i regjistrojnë ata në kopsht. Arsye të tjera të mos regjistrimit mund të jetë mos njohja e ambienteve të kopshteve, mësueset dhe stafin e kopshteve. Nëpërmjet aktiviteteve të organizuara nga kopshti, ata do të njihen me ambientet, mësueset, mënyrat e mësimdhënies, përfitimet e fëmijës nga kopshti dhe në këtë mënyrë synohet të rritet norma e regjistrimit;
4. **Ulja e grupeve të përziera dhe e numrit të fëmijëve në grupet e përziera.** Me rritjen e regjistrimit mund të ulet dhe numri i fëmijëve në grupet e përziera. Duke qenë se ato formohen kur numri i fëmijëve për të formuar grup të I, II dhe III nuk është i mjaftueshëm, rritja e normës së regjistrimit do të mundësojë zvogëlimin e numrit të grupeve të përziera dhe numrin e fëmijëve në këto grupe.

**iii Niveli i ndërhyrjes**

**A: Menaxheriale**

1. Kopshtet në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve planifikon aktivitetet. Për të rritur sa më shumë partneritetin si me komunitetin por edhe motivimin e Këshillit të Prindërve për të qenë aktorë të rëndësishëm në zhvillimin e kopshtit, duhet që Bashkia të njohë disa pika kyçe të zonës ku është kopshti si p.sh.
    1. *Cilat janë karakteristikat kyçe dhe pikat e forta të komunitetit ku ndodhet kopshtië*
    2. *Çfarë mund të bëni ju dhe çfarë mbështetje kërkoni ju për të mbështetur kopshtin në fusha të tilla si disiplinimi pozitiv, ndërgjegjësimi për rëndësinë e edukimit në moshë të hershmeë*
    3. *A ka partneritete të ndërtuara mes kopshtit dhe kulturave të ndryshme të komunitetitë*
2. Kalendari i aktiviteteve i dërgohet Njësisë së Arsimit Parashkollor;
3. Organizohen takime me komunitetin për krijimin e Grupit të Vullnetarëve.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

| **Shtator** | **Tetor-Dhjetor** | **Janar-Mars** (vetëm për kopshtet e NJA) | **Prill-Gusht** (vetëm për kopshtet e NJA) |
|---|---|---|---|
| Prindërit dhe mësuesit takohen për të diskutuar:<br><br>1. Aktivitetet që do realizohen gjatë vitit;<br><br>2. Nevojat që kanë fëmijët dhe komuniteti;<br><br>3. Kopshti rrit informimin mbi rolin dhe përgjegjësinë e Këshillit të Prindërve. | **Kopshti:**<br><br>-Planifikon aktivitetet bazuar te nevojat e fëmijëve dhe komunitetit.<br><br>**Prindërit:**<br><br>-Marrin pjesë tek aktivitetet që ata kanë shprehur dëshirën të jenë pjesëmarrës;<br><br>-Informohen nga kopshti në mënyrë të vazhdueshme për planin që zhvillon kopshti. | Në bashkëpunim me kopshtin dhe bashkinë, organizohen takime me komunitetin për të krijuar **grupin e vullnetarëve** (prindër, studentë, dhe pjestarë të tjerë të komunitetit).<br><br>Grupi i vullnetarëve merr pjesë në organizimin e aktiviteteve të ardhshme. | -Kopshti ofron aktivitete në ambient të hapur;<br><br>-Komuniteti mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete;<br><br>-Prindërit ndihmojnë fëmijën në ndjekjen e detyrave. |

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Rritja e normës së regjistrimit të fëmijëve në kopsht;
2. Angazhim më i madh i Këshillit të Prindërve në kopsht;
3. Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi rëndësinë e arsimit parashkollor dhe nevojën për të pasur më shumë përfshirje nga ana e tyre.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | • Komuniteti<br>• Kopshti<br>• Gjimnazet |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Përgatitja e kalendarit të aktiviteteve | Drejtues i kopshtit | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Shqyrtimi me Bordin e Kopshtit | Drejtues i kopshtit | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Takim me Këshillin e Prindërve | Drejtues i kopshtit | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Organizimi i aktiviteteve | Drejtues i kopshtit | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| **f) Periudha e zbatimit:** | **g) Ndjek zbatimin e projektit:** |
|---|---|
| 2024 | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

| **Nr**. 005 | **Projekti**: Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo Kopësht | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |
|---|---|---|

**a)Përshkrim i shkurtër i projektit**

**i Situata**

| |
|---|
| Kopshtet në Bashkinë Mirditë nuk dihet nëse hartojnë dhe zbatojnë një plan afatmesëm.<br><br>Plani Afatmesëm përmban:<br><br>• Misionin;<br>• Vizionin;<br>• Analiza e gjendjes;<br>• Përparësitë;<br>• Veprimtaritë kryesore për realizimin e përparësive;<br>• Produkti ose treguesit e arritjeve;<br>• Buxheti i përafërt.<br><br>Në rastin se nuk hartohet një plan afatmesëm, kopshtet nuk kanë një analizë të qartë të situatës, objektiva dhe një plan aktivitetesh për të arritur objektivat. |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje |
| Në Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 *"Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë"* përcaktohet kompetenca e hartimit të Planit Afatmesëm të IA dhe rubrikat e tij. Sipas tij, detyrën për ngritjen e grupit të punës nga mësues dhe persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore (me kryetar drejtuesin e kopshtit) për hartimin e planit afatmesëm e ka drejtuesi i kopshtit. |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>Nëpërmjet këtij projekti synohet rritja e kapaciteteve në lidhje me ha+rtimin e planit afatmesëm dhe hartimi i planit në gjithë kopshtet e Bashkisë Mirditë. |
| **A: Ligjore**<br><br>1. Nxjerrja e një Urdhri nga Kryetari i Bashkisë ku përcakton se kompetencat për monitorimin e hartimit dhe zbatimit të planit afatmesëm e ka Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës dhe drejtuesit e kopshteve duhet të raportojnë te ZVAP dhe ii.<br><br>**B: Menaxheriale**<br><br>1. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve për hartimin e planit afatmesëm;<br>2. Zbatimi i Urdhrit nr. 31, neni 49 dhe 50 për hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm në të gjitha kopshtet e Bashkisë Mirditë. |
| **iv Aktivitetet kryesore të projektit** |

1. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve për hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm.
2. Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo kopsht.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Kopshtet vendosin vetë objektiva dhe arrijnë ato;
2. Kopshtet funksionojnë jo vetëm si institucione në varësi të Bashkisë, por kanë edhe plane dhe objektiva të vetat që nxisin zhvillimin më të shpejtë të tyre.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Trajnimi i drejtuesve të kopshteve për hartimin e planit afatmesëm | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 1500 lekë/person | 1500 lekë/person | 1500 lekë/person | 4500 lekë/person |
| 2 | Hartimi i planit afatmesëm në çdo kopsht | Drejtuesit e kopshteve | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| **f) Periudha e zbatimit:** 2024 - 2026 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:** • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |
|---|---|

*Risqet*

| **Risku** | **Mitigimi** |
|---|---|
| Qendrat Shëndetësore dhe Zyra e Gjendjes Civile kanë të dhëna mbi fëmijët në moshë kopshti të ndryshme nga njëra-tjetra dhe/ose të mos kenë të dhëna për të gjithë fëmijët. Në këtë rast rrezikohet që Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës të mos evidentojë listën e fëmijëve në moshë kopshti. | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës ngre një grup pune për unifikimin e të dhënave të marra nga Qendrat Shëndetësore dhe Gjendja Civile. Unifikimi i të dhënave do të bazohet te zona e banimit të fëmijës, emri dhe mbiemri i fëmijës dhe datëlindja. Grupi i punës bashkëpunon vazhdimit me Qendrat Shëndetësore për verifikimin e të dhënave. |
| Regjistrimi fëmijëve sipas zonës së banimit mund të detyrojë prindërit të regjistrojnë fëmijët në kopshte që nuk janë pranë zonës ku ata banojnë realisht, por në kopshte ku kanë zonën e banimit zyrtarisht. | Prindërit kanë të drejtë të kërkojnë që fëmija e tyre të regjistrohet pranë zonës së tyre reale të banimit, nëse mund ta vërtetojnë në mënyrë zyrtare nëpërmjet një kontrate qiraje, kontrate pune, hipoteka e shtëpisë, etj. |

## 2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor

### 2.4.1 Këshilli i Prindërve

*Informacion i përgjithshëm*

Jo të gjitha kopshtet kanë numrin minimal të anëtarëve në Këshillin e Prindërve, të parashikuar sipas legjislacionit në fuqi. Gjatë analizës vihet re qartë që Këshilli i Prindërve nuk është aktiv në kopshte, si dhe nuk ka peshën e duhur, për të sjellë ndryshime funksionale në kopësht. Duket sikur është një strukturë që funksionon formalisht.

Gjithashtu vihet re që temat që diskutohen shpeshpherë lidhen edhe me përgjegjësi të cilat nuk i zgjidh dot as këshilli dhe as vetëm kopshti.

**Temat që diskuton këshilli prindërve, të cilat kanë nevojë të diskutohen në nivele më të larta, për të gjetur zgjidhje.**

- Infrastruktura
- Problematikat e kopshtit
- Mjetet didaktike
- Transporti i fëmijëve
- Marëdhëniet kopësht-komunitet

Për të kryer analiza më të detajuara për këtë temë do të ishte me interes të kishim një grafik, cilat janë temat që këshilli i prindërve u jep zgjidhje, dhe cilat janë temat për të cilat ata kanë nevojë imediate që Bashkia tu japi zgjidhje. Në këtë mënyrë do të kishim një hartë më të qartë përsa i përket nevojave imediate dhe urgjente në secilin kopësht. Gjithashtu është shumë e rëndësishme që dhe bashkia të ketë një informacion të saktë përsa i përket mënyrës se si funksionon Këshilli, dhe sa aktiv është ai në jetën e kopshtit.

Për të fuqizuar këshillin e prindërve shihet tejet i nevojshëm dhe primar detajimi i Urdhrit Nr. 31, në të cilin duhet të vendosen edhe format e raportimit të këshillit, dhe rruga që ndiqet për ti dhënë zgjidhje problemeve që mund të ngrihen nga këshilli.

*Objektiva kryesore:*

Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopësht sipas Udhëzimit Nr. 31 dhe rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve përsa i përket të drejtave dhe detyrimeve të tij.

*Nën-objektivat:*

| **Nr** | **Përshkrimi** |
|---|---|
| 1 | Themelimi i Këshillit të Prindërve në të gjithë Kopshtet sipas Udhëzimit Nr. 31 |
| 2 | Aktivizimi më i madh i Këshillit të Prindërve në menaxhimin e kopshtit |

*Indikatorët e performancës*

| **Kodi** | **Indikatori** | **Shpërndarja gjeografike** | **Matje ne:** | **Agregimi** | **Fakt Aktual** | **Plan Vit 2024** | **Plan Vit 2025** | **Plan Vit 2026** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 017 | Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Këshilli i Prindërve | Fshat | Vlere | Mesatare | 5 | 7 | 7 | 10 |
| 017 | Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të | Periferi | Vlere | Mesatare | 10 | 5 | 5 | 2 |

| Kodi | Indikatori | Shpërndarja gjeografike | Matje ne: | Agregimi | Fakt Aktual | Plan Vit 2024 | Plan Vit 2025 | Plan Vit 2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ngritura nga Këshilli i Prindërve | | | | | | | |
| 017 | Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Këshilli i Prindërve | Qender | Vlere | Mesatare | 5 | 4 | 4 | 3 |
| 016 | Numri i mbledhjeve të Këshillit të Prindërve | Fshat | Vlere | Mesatare | 3 | 3 | 3 | 3 |
| 016 | Numri i mbledhjeve të Këshillit të Prindërve | Periferi | Vlere | Mesatare | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 016 | Numri i mbledhjeve të Këshillit të Prindërve | Qender | Vlere | Mesatare | 3 | 3 | 3 | 3 |
| 015 | Numri i aktiviteteve të kopshtit të organizuara në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve | Fshat | Vlere | Mesatare | 2 | 2 | 2 | 2 |
| 015 | Numri i aktiviteteve të kopshtit të organizuara në bashkëpunim | Periferi | Vlere | Mesatare | 2 | 2 | 2 | 2 |

| Kodi | Indikatori | Shpërndarja gjeografike | Matje ne: | Agregimi | Fakt Aktual | Plan Vit 2024 | Plan Vit 2025 | Plan Vit 2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | me Këshillin e Prindërve | | | | | | | |
| 015 | Numri i aktiviteteve të kopshtit të organizuara në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve | Qender | Vlere | Mesatare | 3 | 3 | 3 | 3 |
| 014 | Numri i aktiviteteve të kopshtit ku Këshilli i Prindërve ka marrë pjesë | Fshat | Vlere | Mesatare | 3 | 3 | 3 | 3 |
| 014 | Numri i aktiviteteve të kopshtit ku Këshilli i Prindërve ka marrë pjesë | Periferi | Vlere | Mesatare | 2 | 2 | 2 | 2 |
| 014 | Numri i aktiviteteve të kopshtit ku Këshilli i Prindërve ka marrë pjesë | Qender | Vlere | Mesatare | 3 | 3 | 3 | 3 |
| 013 | Numri i anëtarëve në Këshillin e Prindërve | Fshat | Vlere | Mesatare | 5 | 5 | 5 | 5 |
| 013 | Numri i anëtarëve në Këshillin e Prindërve | Periferi | Vlere | Mesatare | 5 | 5 | 5 | 5 |

| Kodi | Indikatori | Shpërndarja gjeografike | Matje ne: | Agregimi | Fakt Aktual | Plan Vit 2024 | Plan Vit 2025 | Plan Vit 2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 013 | Numri i anëtarëve në Këshillin e Prindërve | Qender | Vlere | Mesatare | 7 | 7 | 7 | 7 |
| 012 | Numri i trajnimeve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve | Fshat | Vlere | Mesatare | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 012 | Numri i trajnimeve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve | Periferi | Vlere | Minimum | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 012 | Numri i trajnimeve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve | Qender | Vlere | Mesatare | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 011 | Numri i kopshteve që kanë themeluar Këshillin e Prindërve | Fshat | Vlere | Shumatore | 5 | 7 | 10 | 10 |
| 011 | Numri i kopshteve që kanë themeluar Këshillin e Prindërve | Periferi | Vlere | Shumatore | 5 | 7 | 10 | 10 |
| 011 | Numri i kopshteve që kanë themeluar Këshillin e Prindërve | Qender | Vlere | Shumatore | 5 | 7 | 10 | 10 |

*Lista e Aksioneve*

| Numri | Projekti | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxhet Vit 2024 | Buxhet Vit 2025 | Buxhet Vit 2026 | Total periudhe |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 007 | Fuqizimi i Këshillit të Prindërve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | 2 | 5 | 7 | 7 | 10 |
| 006 | Themelimi i Këshillit të Prindërve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | 5 | 5 | 10 | 10 | 10 |

*Lista e projekteve*

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 006 | **Projekti**: Themelimi i Këshillit të Prindërve | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Sipas të dhënave të Bashkisë nga 17 kopshte vetëm dy kopshte në Njësitë Administrative Rrëshen dhe Rubik e kanë ngritur Këshillin e Prindërve, kopshtet e tjera nuk e kanë themeluar këtë këshill ndërsa kopshtet në Fan dhe Reps, janë në proces të themelimit të këtyre strukturave. | | |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje | | |
| Këshilli i Prindërve përbën një prej aktorëve kryesorë të interesuar për një shërbim sa më të mirë të arsimit parashkollor për këtë arsye është shumë e rëndësishme që të themelohet në të gjitha kopshtet e Bashkisë Mirditë. | | |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>Nëpërmjet këtij projekti synohet:<br><br>1. Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht;<br>2. Rritja e pjesëmarrjes së prindërve në Këshillat e Prindërve. Sipas Udhëzimit nr. 31, Këshilli mund të ketë 6-9 anëtarë. Jo të gjitha kopshtet e përmbushin këtë kriter. Bashkia nëpërmjet monitorimit të saj gjatë themelimit do të sigurojë përmbushjen e këtij standardi (bëjnë përjashtim kopshtet të cilat kanë më pak se 10 fëmijë të regjistruar). | | |

**iii Niveli i ndërhyrjes**

**A: Menaxheriale**

1. Kopshtet themelojnë Këshillin e Prindërve dhe i dërgojnë listën e anëtarëve Njësisë së Arsimit Parashkollor sipas Udhëzimit nr. 31;
2. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës monitoron procesin e themelimit të Këshillave të Prindërve për të siguruar që çdo kopsht i përmbahet Udhëzimit nr. 31 dhe monitoron mbarëvajtjen e Këshillit të Prindërve përgjatë vitit.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht;
2. Monitorimi i procesit të themelimit të Këshillit të Prindërve.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht sipas Udhëzimit nr. 31.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Themelimi i Këshillit të Prindërve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Monitorimi i themelimit dhe mbarëvajtjes së Këshillit | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| f) Periudha e zbatimit: | g) Ndjek zbatimin e projektit: |
|---|---|
| 2024-2026 | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

| **Nr**. 007 | **Projekti**: Fuqizimi i Këshillit të Prindërve | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |
|---|---|---|
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Numri i anëtarëve të këshillit të prindërve, që i përkasin gjinisë “femër” është më i lartë, në krahasim me numrin e anëtarëve të gjinisë “mashkull”, në të vetmin Këshill që është ngritur në NjA Rrëshen. Në këshillin e prindërve të kopshtit të qytetit të Rrëshenit raporti është 6 anëtare të gjinisë “femër” me 1 anëtarë të gjinisë “mashkull”. Këshilli i prindërve mblidhet të paktën tre herë në vit. | | |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje | | |
| Duke qenë se pothuajse të gjitha kopshtet e kësaj Bashkie nuk e kanë themeluar këshillin e prindërve, mund të themi se Këshilli i Prindërve nuk është aktiv në kopshte, si dhe nuk ka peshën e duhur, për të sjellë ndryshime funksionale në kopshte. Duket sikur është një strukturë që funksionon formalisht. Gjithashtu vihet re që temat që diskutohen shpesh herë lidhen edhe me përgjegjësi të cilat nuk i zgjidh dot as Këshilli i Prindërve dhe as vetëm kopshti dhe nuk është e qartë se si temat që Këshilli i Prindërve diskuton, adresohen në Bashki për të gjetur zgjidhje.<br><br>Duke qenë se Këshilli i Prindërve përbën një prej aktorëve kryesorë të interesuar për një shërbim sa më të mirë të arsimit parashkollor dhe nëse funksionon vetëm formalisht, atëherë është e vështirë që shumë probleme të kopshteve, që kërkojnë edhe buxhet të madh, të jenë prioritet për Këshillin Bashkiak ose Bashkinë. | | |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>Nëpërmjet këtij projekti synohet:<br><br>1. Aktivizimi më i madh i Këshillit të Prindërve. Në organizimin e aktiviteteve do të kërkohet përfshirja e anëtarëve të Këshillit të Prindërve dhe në këtë mënyrë do të rritet angazhimi i tyre në kopsht.<br><br>Për të fuqizuar Këshillin e Prindërve shihet tejet i nevojshëm dhe primar detajimi i Urdhrit Nr. 31, në të cilin duhet të vendosen edhe format e raportimit të Këshillit dhe rruga që ndiqet për t’i dhënë zgjidhje problemeve që mund të ngrihen nga Këshilli. | | |

**iii Niveli i ndërhyrjes**
**A: Ligjore**

1. Hartimi i një protokolli të unifikuar ndërmjet institucioneve (Bashki, NJA, ZVAP), rreth mënyrës së raportimit të këshillit dhe rrugës që këshilli ndjek për t'i dhënë zgjidhje problemeve të ngritura në mbledhje. Detajimi nëpërmjet një udhëzimi të posaçëm siç është udhëzimi nr.25 për Bordin e Kopshtit, që edhe këshilli për çështje të cilat kanë nevojë për zgjidhje nga bashkia, të raportojë pranë bashkisë.

**B: Menaxheriale**

1. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës organizon një trajnim në fillim të vitit për drejtuesit e kopshteve mbi të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Prindërve. Ky trajnim do të organizohet së bashku me trajnimin për Bordin e Kopshtit kështu që nuk do të ketë kosto shtesë;
2. Drejtuesit e kopshteve organizojnë një takim me anëtarët e Këshillit të Prindërve për t'i trainuar mbi të drejtat dhe detyrat e tyre;
3. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës ndjek dhe asiston drejtuesit e kopshteve në trajnimet që ata kryejnë me Këshillin e Prindërve.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Hartimi i protokollit të unifikuar ndërmjet institucioneve (Bashki, NJA, ZVAP), rreth mënyrës së raportimit të këshillit dhe rrugës që këshilli ndjek për t'i dhënë zgjidhje problemeve të ngritura në mbledhje;
2. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës;
3. Trajnimi i anëtarëve të Këshillit të Prindërve nga drejtuesit e kopshteve.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve dhe drejtuesve.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
| --- | --- |
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | • OJF<br>• |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Hartimi i protokollit të unifikuar ndërmjet institucioneve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Trajnimi i drejtuesve të kopshteve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 1500 lekë/person | 1500 lekë/person | 1500 lekë/person | 1500 lekë/person |
| 3 | Trajnimi i anëtarëve të Këshillit të Prindërve | Drejtuesi i kopshtit | | 1500 lekë/person | 1500 lekë/person | 1500 lekë/person | 1500 lekë/person |
| | | | | 3000 | 3000 | 3000 | 3000 |

| **f) Periudha e zbatimit:** 2024-2026 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:** Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |
|---|---|

*Risqet*

| Risku | Mitigimi |
|---|---|
| Mungesa e drejtuesve të kopshteve mund të shkaktojë pamundësi të mësueseve për të kryer trajnimet në Bashki, për të trainuar anëtarët e Këshillit të Prindërve dhe për të themeluar Këshillin e Prindërve, për shkak të volumit të madh të përgjegjësive që kanë. | Brenda vitit 2024-2026 do të shihet mundësia që të zbatohet Udhëzimi Nr. 14 për punësimin e drejtorëve për kopshtet deri në 5 grupe fëmijësh. |

### 2.4.2 Bordi i Kopshtit

*Informacion i përgjithshëm*

Në kopshtet publike të Qytetit Mirditë, vihet re e njëjta situatë me Këshillin e Prindërve ku vetëm një kopësht e ka themeluar Bordin e Kopështit në NjA Rrëshen.

Sipas të dhënave të raportuara në nivel Bashkie, nga 17 kopshte në total, 16 kopshte nuk e kanë themeluar Bordin e Prindërve. Vetëm një kopësht në Njësinë Administrative Rrëshen e ka themeluar këtë organizëm.

Ndërkohë sipas Udhëzimit Nr. 25, bordi përbëhet nga 7 anëtarët, ndërkohë në kopshtet publike të Bashkisë Mirditë, numri minimal i anëtarëve të bordit të kopshtit është 5, numri mesatar është 7, ndërsa numri maksimal i anëtarëve është 9.

Ndërkohë sipas Udhëzimit, Nr. 25, në ngritjen e bordit u kushtohet kujdes i veçantë përfaqësimit gjinor. Në kopshtin e Rrëshenit, është evidente se të gjithë anëtarët i përkasin gjinisë “femër”, konkretisht numri mesatar i anëtarëve të gjinisë “femër” eshtë 7.

Bordi mblidhet jo me pak se tri herë në vit. Mbledhjet e tjera zhvillohen me nismën e kryetarit të bordit ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij. Ndërkohe në kopshtin e njësisë Rrëshen vihet re se numri minimal i mbledhjeve të bordit është 3, numri mesatar është 5, ndërsa numri maksimal është 7.

*Objektiva kryesore:*

Themelimi dhe fuqizimi i Bordit të Kopshtit si organizëm që siguron mbarëvajtjen e arsimit parashkollor dhe adreson çështjet problematike për zgjidhjen e tyre.

*Nën-objektivat:*

| **Nr** | **Përshkrimi** |
|---|---|
| 1 | Themelimi i Bordit të Kopshtit në çdo kopësht ku mungon |
| 2 | Rritja e aktivizimit të Bordit të Kopshtit në adresimin e problematikave të kopshtit |

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 3 | Adresimi i çështjeve të diskutuara në organizmat e kopshteve në Bashki |

*Indikatorët e performancës*

*Lista e Aksioneve*

| Numri | Projekti | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxhet Vit 2024 | Buxhet Vit 2025 | Buxhet Vit 2026 | Total periudhe |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 010 | Ngritja e një strukture lidhëse mes Bashkisë dhe kopshteve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 009 | Fuqizimi i Bordit të Kopshtit | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 008 | Themelimi i Bordit të Kopshtit | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |

*Lista e projekteve*

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 008 | **Projekti**: Themelimi i Bordit të Kopshtit | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Në Bashkinë e Mirditës nga 17 kopshte në total, 16 kopshte nuk e kanë themeluar Bordin e Kopshtit. Sipas Udhëzimit Nr. 25, bordi përbëhet nga 7 anëtarë, ndërkohë në të vetmin kopësht të Bashkisë Mirditë ku është themeluar Bordi i Kopshtit, numri minimal i anëtarëve të Bordit të Kopshtit është 5, numri mesatar është 7, ndërsa numri maksimal i anëtarëve është 9. | | |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje | | |
| Bordi i Kopshtit ka si synim të sigurojë që shërbimi arsimor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit nëpërmjet njohjes së problemeve, zgjidhjes ose adresimit për zgjidhjen e tyre. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor në përputhje me aktet ligjore në fuqi.<br><br>Megjithatë, jo të gjitha kopshtet e kanë themeluar Bordin e Kopshtit. Gjithashtu, nuk shpjegohet qartë se cila është procedura që ndiqet nga Bordi, për zgjidhjen e problemeve që ngrihen në të.<br><br>Një problematikë e hasur në disa prej kopshteve të Njësive Administrative është që nuk kanë drejtues. Është Drejtuesi i Shkollës së Arsimit Bazë që luan rolin e drejtuesit të kopshtit. Si pasojë, kopshtet mund të funksionojnë së bashku me Bordin e Shkollës. Në këtë rast, për shkak të vëmendjes më të madhe që i kushtohet arsimit bazë, dhe për faktin që numri i nxënësve, mësuesve dhe si pasojë edhe i çështjeve që duhen trajtuar është më i madh në arsimin bazë, problemet e kopshteve mund të lihen në hije. | | |
| **ii Synimi i projektit** | | |

Është e nevojshme të ndërhyet për të themeluar Bordin e Kopshtit në kopshtet që ende nuk e kanë themeluar dhe të ndahet Bordi i Kopshtit nga ai i shkollave.

Nëpërmjet këtij projekti synohet:

1. Themelimi i Bordit në të gjitha kopshtet.
2. Ritja e kontrollit dhe e monitorimit të funksionimit të Bordeve

**iii Niveli i ndërhyrjes**
**A: Ligjore**

1. Krijimi i një vendimi të posaçëm nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës për ngritjen dhe funksionimin e Bordit në kopshte ku nuk ka drejtor, ku përcaktohet si person përgjegjës për këto detyra (të përcaktuara në Udhëzimin nr. 25, *"Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të Institucionit Arsimor"*) drejtuesi i 5 grupeve (Në projektin 020, është planifikuar vendosja e 1 drejtuesi për 5 grupe për kopshtet që menaxhohen nga drejtuesit e arsimit bazë).

**B: Menaxheriale**

1. Pas regjistrimit të fëmijëve dhe fillimit të procesit mësimor të kopshteve, Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës, njofton nëpërmjet një shkrese zyrtare me e-mail drejtuesit/mësuesit përgjegjës për themelimin e Bordit të Kopshtit brenda një afati 10 ditor.
2. Themelimi i Bordit të Kopshtit në kopshte dhe dërgimi i organogramës së Bordit në Bashki.
3. Drejtuesi i kopshtit njofton Njësinë e Arsimit Parashkollor sa herë që Bordi i Kopshtit mblidhet dhe çështjet që diskuton duke i dërguar procesverbalët ose dokumente të tjera shtesë të mbajtura nga Sekretari i Bordit.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Themelimi i Bordit të Kopshtit në çdo kopsht

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Krijimi i Bordit dhe funksioni i plotë i tij në çdo kopsht;
2. Ritja e monitorimit të Bordit të Kopshtit nga ana e Bashkisë.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës; | |

| | |
|---|---|
| • Kryetari i Bashkisë. | |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Themelimi i Bordit të Kopshtit në çdo kopsht | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>**2024-2026** | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 009 | **Projekti**: Fuqizimi i Bordit të Kopshtit | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |

**a)Përshkrim i shkurtër i projektit**

**i Situata**

Bordi duhet të mblidhet jo më pak se tri herë në vit. Mbledhjet e tjera zhvillohen me nismën e kryetarit të Bordit ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij. Ndërkohë, në bashkinë Mirditë, në NjA Rrëshen në kopshtin ku është themeluar Bordi vihet re se numri minimal i mbledhjeve të bordit është 3, numri mesatar është 5, ndërsa numri maksimal është 7.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Bordi i Kopshtit ka si synim të sigurojë që shërbimi arsimor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit nëpërmjet njohjes së problemeve, zgjidhjes ose adresimit për zgjidhjen e tyre. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Thuajse të gjitha kopshtet e bashkisë Mirditë, nuk e kanë themeluar këtë strukturë duke mos i dhënë një vëmendje të veçantë dhe rëndësinë e duhur këtij organizmi. Edhe në kopshtin në të cilin është krijuar, numri i takimeve nuk është shumë i shpeshtë që të tregojë impaktin e tij në jetën e kopshtit. Gjithashtu, nuk shpjegohet qartë se cila është procedura që ndiqet nga Bordi, për zgjidhjen e problemeve që ngrihen në të.

Pra, pavarësisht se në pjesën më të madhe të kopshteve Bordi është themeluar, synimi i tij nuk realizohet praktikisht.

**ii Synimi i projektit**

Nëpërmjet këtij projekti synohet:

1. Fuqizimi i Bordit të Kopshtit si organizëm që siguron mbarëvajtjen e arsimit parashkollor dhe adreson çështjet problematike për zgjidhjen e tyre.

**iii Niveli i ndërhyrjes**

**A: Menaxheriale**

1. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës organizon një trajnim në fillim të vitit për drejtuesit e kopshteve mbi të drejtat dhe detyrat e Bordit të Kopshtit;
2. Drejtuesit e kopshteve organizojnë një takim me anëtarët e Bordit për t’i trainuar mbi të drejtat dhe detyrat e tyre;
3. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës ndjek dhe asiston drejtuesit e kopshteve në trajnimet që ata kryejnë me Bordin e Kopshtit.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës;
2. Trajnimi i anëtarëve të Bordit të Kopshtit nga drejtuesit e kopshteve.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Bordit të Kopshteve dhe drejtuesve.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | • OJF |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Trajnimi i drejtuesve të kopshteve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 1500 | 1500 | 1500 | 4500 |
| 2 | Trajnimi i anëtarëve të Bordit të kopshtit | Drejtuesit e kopshteve | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 1500 | 1500 | 1500 | 4500 |

| **f) Periudha e zbatimit:** | **g) Ndjek zbatimin e projektit:** |
|---|---|
| 2024-2026 | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

| **Nr**. 010 | **Projekti**: Ngritja e një strukture lidhëse mes Bashkisë dhe kopshteve | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |
|---|---|---|

**a)Përshkrim i shkurtër i projektit**

**i Situata**

Edhe pse në pjesën më të madhe kopshtet e Bashkisë Mirditë e kanë ngritur Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, nuk është e qartë se si temat që diskutojnë dhe problematikat që evidentojnë adresohen në Bashki për të gjetur zgjidhje.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Duke qenë se pjesa më e madhe e kopshteve nuk i kanë të themeluara këto struktura, atëherë mungon edhe raportimi në Bashki i nevojave të ndryshme që kopshtet kanë. Kjo do të thotë se nevojat e kopshteve të evidentuara në takime nuk adresohen në Bashki dhe nuk diskutohen në Këshillin e Bashkisë për të gjetur zgjidhje. Për këtë arsye është e nevojshme të ndërtohet një urë komunikimi mes këtyre organizmave dhe Bashkisë.

**ii Synimi i projektit**

Duke u themeluar organizmat që mungojnë në të gjitha kopshtet e Njësive Administrative atëherë do të jetë më e lehtë që këto struktura të funksionojnë dhe të raportojnë në Bashki. Për anëtarët e Këshillit, Bordit dhe Komisionit të kopshteve pranë NJA, mund të jetë e vështirë

pjesëmarrja në takimet e Këshillit të Bashkisë kur diskutohet buxheti apo planifikohen investimet. Duke munguar një zë në këto takime që thekson problematikat e kopshteve, shihet e vështirë gjetja e zgjidhjeve të tyre.

Ndaj, nëpërmjet këtij projekti synohet që të krijohet një grup përfaqësues me pjesëmarrës nga Këshillat e Prindërve, Bordeve të Kopshteve dhe Komisioneve nga të gjitha kopshtet e Bashkisë, që do të ketë kontakte me të gjitha organizmat në gjithë kopshtet dhe do të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak sa herë diskutohen çështje që lidhen me arsimin parashkollor. Në këtë mënyrë synohet që të ngrihet zëri mbi problematikat e kopshteve dhe të gjenden zgjidhje për to.

**iii Niveli i ndërhyrjes**
**A: Ligjore**

1. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës krijon një rregullore mbi të drejtat dhe detyrat e Grupit Përfaqësues, mënyrën e raportimit, mënyrën e njoftimit për mbledhje, etj.

**B: Menaxheriale**

1. Sapo në të gjitha kopshtet janë themeluar Këshilli, Bordi dhe Komisioni, krijohet Grupi Përfaqësues. Grupi Përfaqësues nuk ka minimum dhe maksimum anëtarësh. Anëtarët mund të jenë nga çdo kopsht apo organizëm dhe pjesëmarrja në të është vullnetare;
2. Kur ky grup formohet, drejtuesit e kopshteve (të trainuar tashmë nga Bashkia) informojnë anëtarët mbi të drejtat, detyrimet dhe protokollin e adresimit të një çështjeje.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Hartimi i rregullores për ngritjen e Grupit Përfaqësues;
2. Krijimi i Grupit Përfaqësues;
3. Informimi i anëtarëve të Grupit nga drejtuesit e kopshteve mbi të drejtat dhe detyrimet.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Ngritja e një grupi përfaqësues i 3 organizmave të kopshteve, që do të përfaqësojë kopshtet në nivelin vendor;
2. Theksimi më i madh i problematikave të kopshteve në Bashki

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|

| | |
|---|---|
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | • OJF |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Hartimi i rregullores | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Krijimi i Grupit Përfaqësues | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës/Drejtuesit e kopshteve | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Informimi i anëtarëve të Grupit nga drejtuesit e kopshteve mbi të drejtat dhe detyrimet | Drejtuesit e kopshteve | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2024 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

### *Risqet*

| Risku | Mitigimi |
|---|---|
| Mungesa e drejtuesve të kopshteve mund të shkaktojë pamundësi të mësueseve për të kryer trajnimet në Bashki, për të trainuar anëtarët e Bordit të Kopshtit | Brenda vitit 2024-2026 do të shihet mundësia që të zbatohet Udhëzimi Nr. 14 për punësimin e drejtorëve për |

| Risku | Mitigimi |
|---|---|
| dhe për të themeluar Bordin e Kopshtit, për shkak të volumit të madh të përgjegjësive që kanë. | kopshtet deri në 5 grupe fëmijësh. |

### 2.4.3 Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit

*Informacion i përgjithshëm*

Sipas Urdhrit Nr.31 datë 28.01.2020, çdo institucion duhet të ngrejë Komisionin e tij.

Asnjë nga kopshtet publike nuk e ka ngritur komisonin e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit në Bashkinë Mirditë. Pjesa më e madhe e kopshteve janë shprehur se nuk kanë informacion lidhur me këtë Komision duke mos i dhënë rëndësinë e duhur.

*Objektiva kryesore:*

Themelimi dhe fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit sipas Udhëzimit nr. 31.

*Nën-objektivat:*

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | Themelimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në çdo kopësht |
| 2 | Fuqizimi i Komisionit për të marrë pjesë në identifikimin e nevojave dhe për t'i dhënë zgjidhje problemeve të krijuara në kopshte. |

*Indikatorët e performancës*

*Lista e Aksioneve*

| Numri | Projekti | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxhet Vit 2024 | Buxhet Vit 2025 | Buxhet Vit 2026 | Total periudhe |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 013 | Fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| Numri | Projekti | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxhet Vit 2024 | Buxhet Vit 2025 | Buxhet Vit 2026 | Total periudhe |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 012 | Ngritja i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |

*Lista e projekteve*

<table>
<tr><td>Nr. 011</td><td>Projekti: Ngritja i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit</td><td>Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>Funksioni: 09</td></tr>
<tr><td colspan="3">a)Përshkrim i shkurtër i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="3">i Situata<br><br>Sipas Urdhrit Nr.31 datë 28.01.2020, çdo institucion duhet të ngrejë Komisionin e tij.<br><br>Të gjitha kopshtet publike të Bashkisë Mirditë, nuk e kanë ngritur Komisioni e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit. Kopshtet nuk kanë mjaftueshëm informacion për këtë strukturë dhe nuk e kanë themeluar si organizëm drejtues.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</td></tr>
<tr><td colspan="3">Disa prej detyrave kryesore të Komisionit (sipas Urdhërit nr. 31 "Miratimin e rregullores, për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë") janë: a) mbikëqyr rregullisht në institucionin arsimor kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve dhe ruajtjen e mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve; b) identifikon nevojat për mirëmbajtje të institucionit; c) përcakton nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve; ç) organizon veprimtari ndërgjegjësuese me nxënës, mësues dhe prindër për kushtet e ruajtjes së shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes së mjediseve e pajisjeve të institucionit.<br><br>Detyrat e mësipërme janë shumë të rëndësishme dhe mungesa e Komisionit ose funksionimi vetëm formal i tij bën që këto detyra të mos mbulohen fare ose të mbulohen pjesërisht. Gjithashtu, për kopshtet brenda godinave të shkollave ku Komisioni është i integruar me Komisionin e Shkollës shkakton të njëjtën problematikë.</td></tr>
<tr><td colspan="3">ii Synimi i projektit</td></tr>
</table>

1. Ngritja e Komisionit në të gjitha kopshtet publike të Bashkisë
2. Informimi i bashkisë rreth problemeve dhe tematikave për të cilat diskutohet në Komision, por që është e nevojshme ndërhyrja e bashkisë për t'i dhënë zgjidhje.

**iii Niveli i ndërhyrjes**
**A: Ligjore**

1. Krijimi i një vendimi të posaçëm për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Shëndetit, për kopshtet ku nuk ka drejtor, ku përgjegjësia e themelimit të Komisionit sipas Udhëzimit nr. 31 i kalon një mësuesi.
2. Nxjerrja e një Urdhri nga Kryetari i Bashkisë ku kompetencën për themelimin dhe monitorimin e Komisionit të Shëndetit e ka Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës pranë Bashkisë.

**B: Menaxheriale**

1. Pas regjistrimit të fëmijëve dhe fillimit të procesit mësimor të kopshteve, Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës, njofton nëpërmjet një shkrese zyrtare me e-mail drejtuesit/mësuesit përgjegjës për themelimin e Komisionit të Shëndetit brenda një afati 10 ditor.
2. Themelimi i Komisionit të Shëndetit në kopshte dhe dërgimi i organogramës së Komisionit në Bashki.
3. Drejtuesi i kopshtit/mësuesi përgjegjës plotëson në Platformën Digjitale/njofton Njësinë e Arsimit Parashkollor sa herë që Komisioni mblidhet dhe çështjet që diskuton.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Themelimi i Komisionit të Shëndetit çdo vit në çdo kopsht.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Krijimi i Komisionit dhe funksioni i plotë i tij në çdo kopsht

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | |

| e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv) | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Emertimi** | **Pergjegjes** | **Fakt Aktual** | **Buxheti Viti 2024** | **Buxheti Viti 2025** | **Buxheti Viti 2026** | **Total** |
| 1 | Themelimi i Komisionit të Shëndetit çdo vit në çdo kopsht; | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:** 2024-2026 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:** Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr.** 012 | **Projekti**: Fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |

**a)Përshkrim i shkurtër i projektit**

**i Situata**

Sipas Urdhrit Nr.31 datë 28.01.2020, çdo institucion duhet të ngrejë Komisionin e tij.

Asnjë nga kopshtet publike të kësaj bashkie nuk e ka themeluar Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit. Kopshtet e kanë lënë në hije këtë strukturë duke mos i dhënë rëndësinë që i takon dhe duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në ecurinë dhe mbarëvajtjen e kopshteve. Të 17 kopshtet e kësaj Bashkie nuk e kanë ngritur komisionin.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Disa prej detyrave kryesore të Komisionit (sipas Urdhërit nr. 31, datë 28.01.2020 *„Miratimin e rregullores, për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë“*) janë: a) mbikëqyr rregullisht në institucionin arsimor kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve dhe ruajtjen e mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve; b) identifikon nevojat për mirëmbajtje të institucionit; c) përcakton nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve; ç) organizon veprimtari ndërgjegjësuese me nxënës, mësues dhe prindër për kushtet e ruajtjes së shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes së mjediseve e pajisjeve të institucionit.

| |
|---|
| Detyrat e mësipërme janë shumë të rëndësishme dhe funksionimi vetëm formal i tij bën që këto detyra të mos mbulohen fare ose të mbulohen pjesërisht. |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>1. Fuqizimi i komisionit për të marrë pjesë në identifikimin e nevojave dhe për t'i dhënë zgjidhje problemeve të krijuara në kopshte. |
| **iii Niveli i ndërhyrjes**<br><br>**A: Menaxheriale**<br><br>1. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës organizon një trajnim për drejtuesit e kopshtit për të drejtat dhe detyrimet e Komisionit, mënyrën e adresimit të problemeve, etj.<br>2. Drejtuesit e Kopshteve organizojnë takime informuese me anëtarët e Komisionit për të drejtat, detyrimet e tyre dhe mënyrën e adresimit të problemeve. |
| **iv Aktivitetet kryesore të projektit**<br><br>1. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës;<br>2. Trajnimi i anëtarëve të Komisionit nga drejtuesit e kopshteve. |
| **b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**<br><br>1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Komisionit dhe drejtuesve të kopshteve. |

| | |
|---|---|
| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)<br><br>• Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)<br><br>• OJF |
| e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv) | |

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Trajnimi i drejtuesve të kopshteve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 1500 | 1500 | 1500 | 4500 |
| 2 | Trajnimi i anëtarëve të Komisionit | Drejtuesit e kopshteve | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 1500 | 1500 | 1500 | 4500 |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2024-2026 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

*Risqet*

| Risku | Mitigimi |
|---|---|
| Mungesa e drejtuesve të kopshteve mund të shkaktojë pamundësi të mësueseve për të kryer trajnimet në Bashki, për të trainuar anëtarët e Komisionit dhe për të themeluar atë, për shkak të volumit të madh të përgjegjësive që kanë. | Brenda vitit 2021-2023 do të shihet mundësia që të zbatohet Udhëzimi Nr. 14 për punësimin e drejtorëve për kopshtet deri në 5 grupe fëmijësh. |

# 3. Proceset Kryesore - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

## *3.1 Qëllimi*

Proceset kryesore janë ato procese që i shërbejnë drejtpërdrejtë përmbushjes së objektivave strategjike ose qëllimit të institucionit. Këto proçese ofrojnë një pjesë të konsiderueshme të performancës së një institucioni dhe konsumojnë një pjesë të konsiderueshme të burimeve. Në lidhje me kopshtet publike, fëmijët regjistrohen dhe mbërrijnë në objekt (këtu fillon procesi) dhe largohen pasi të kenë marrë arsimin parashkollor (procesi përfundon).

Plani i përmirësimit të shërbimit ka si qëllim rritjen e identifikimit, vlerësimit dhe trajtimit më të mirë të rasteve të fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët jetimë, me prindër të divorcuar, fëmijëetj), fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe fëmijët me aftësi të kufizuar.

## *3.2 Objektiva të përgjithshëm*

Objektivat kryesore të planeve të përmirësimit në lidhje me Proceset Kryesore janë:

1. Rritja e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi të kufizuar;
2. Përmirësimi i procesit të menaxhimit të rasteve të identifikuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në nevojë për përfshirje sociale dhe me aftësi të kufizuar.

## 3.3 Përfshirja sociale

### 3.3.1 Identifikimi i nevojave për përfshirje

*Informacion i përgjithshëm*

Bashkia Mirditë nuk e ka të ngritur Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR). NJVNR ka rol në identifikimin e nevojave për shërbime për të gjitha kategoritë në nevojë duke përfshirë grupin e fëmijëve në sistemin arsimit parashkollor që përballen me përjashtimin social si rrjedhojë e varfërisë, mungesës së punësimit, shëndetit, diskriminimit, strehimit të sigurt, etj.

Bashkia nuk ka në strukturën e saj organizative një grup proaktiv për identifikimin e fëmijëve me nevojë për përfshirje sociale. Ajo i identifikon fëmijët me nevojë për përfshirje sociale nëpërmjet raportimit të stafit të shkollave dhe kopshteve, familjeve që marrin ndihmë ekonomike dhe familjet që kanë anëtarë me aftësi të kufizuar.

Numri i fëmijëve me nevojë për përfshirje sociale të regjistruar në kopshtet publike të Bashkisë Mirditë është i vogël, përkatësisht vetëm 2 fëmijë nga komuniteti rom ndërkohë një pjesë e

fëmijëve të komunitetit Egjiptian ndjekin kopshtin e NjA Rrëshen. Fëmijë nga familje me ndihmë ekonomike janë 51, të shpërndarë në të gjitha NjA të Bashkisë Mirditë.

*Objektiva kryesore:*

Rritja e identifikimit dhe vlerësimit të rasteve të fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët jetimë, me prindër të divorcuar, etj);

*Nën-objektivat:*

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | Ngritja e NJVNR në Bashkinë Mirditë |
| 2 | Identifikimi dhe vlerësimi i fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social |

*Lista e projekteve*

| **Nr.** 013 | **Projekti**: Ngritja e NJVNR në NjA Rrëshen dhe Rubik | **Programi Buxhetor:** 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët<br><br>**Funksioni:** 10 |
|---|---|---|
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Bashkia Mirditë nuk e ka të ngritur Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR) pranë Njësive Administrative.<br><br>NJVNR ka rol në identifikimin e nevojave për shërbime për të gjitha kategoritë në nevojë duke përfshirë grupin e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor që përballen me përjashtimin social si rrjedhojë e varfërisë, shëndetit, diskriminimit, strehimit të sigurt, etj. Për këtë arsye nuk ka të dhëna të numrit të fëmijëve gjithsej që janë të identifikuar në nevojë në moshë për kopësht të të gjitha profileve të nevojave. | | |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje | | |
| Si rrjedhojë e mungesës së NJVNR në Bashkinë Mirditë janë hasur këto probleme:<br><br>• ka mungesë të informacionit për fëmijët në kushtet e përjashtimit social dhe me potencial për të përfituar shërbimet e kopshtit; | | |

| |
|---|
| • ka mungesë të vlerësimit të nevojave të grupeve në nevojë për hartimin e politikave, ngritjes së shërbimeve dhe adresimit të nevojave në nivel Bashkie;<br>• ka mospërputhje të theksuar informacioni ndërmjet ZVAP, Bashkisë, Njësive Administrative dhe kopshteve mbi numrin e fëmijëve me nevojë për përfshirje sociale;<br>• ka mungesë të paketave të lehtësimit për përfshirjen sociale si frekuentimi i kopshtit pa pagesë për fëmijët rom dhe egjiptian dhe për fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike.<br><br>Për të realizuar funksionet e përcaktuara, Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit, duhet të ketë të paktën:<br><br>a) një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6 000 deri në 10 000 banorë (Nenet 36 dhe 37 të Ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”);<br><br>b) një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3 000 fëmijë (Në përputhje me Ligjin “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”);<br><br>c) administrator shoqëror (Detyra sipas ligjit për ndihmën ekonomike) |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>Synimi i këtij projekti është ngritja e NJVNR kryesisht në Bashkinë qendër.<br><br>1. Identifikikohen dhe vlerësohen fëmijët pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, etj);<br>2. Ngrihet një sistem i unifikuar për mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe analizimin e tyre për të gjithë fëmijët në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti;<br>3. Hartohen politika dhe ofrohet paketa e shërbimeve për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale dhe në moshë për kopsht;<br>4. Ofrohet asistenca për fëmijët e identifikuar me nevoja të ndryshme brenda ambjentit të kopshtit. |
| **iii Niveli i ndërhyrjes**<br>**A: Ligjore**<br><br>Sipas Ligjit 121/2016 *“Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”,* neni 36, është detyra e Bashkisë të ngrejë pranë Njësive Administrative Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit dhe të caktojë nga një punonjës social për gjashtë deri në dhjetë mijë banorë. Për këtë arsye është i nevojshëm:<br><br>1. Urdhër nga Kryetari i Bashkisë për ngritjen e NJVNR |

| |
|---|
| 2. Nxjerrja e një VKB për miratimin e pagave të punonjësve të strukturave të NJVNR pranë Njësive Administrative.<br><br>**B: Menaxheriale**<br><br>NJVNR, duhet të ketë të paktën:<br><br>1. një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6,000 deri në 10,000 banorë;<br>2. një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3,000 fëmijë;<br>3. administrator shoqëror.<br><br>Detyrat e NJVNR do të jenë:<br><br>1. Identifikimi i rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë<br>2. Vlerësimi fillestar i nevojave dhe riskun për individët në nevojë<br>3. Informimi dhe këshillimi publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla<br>4. Hartimi i planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes<br>5. Bashkërendimi i mbështetjes për individët e familjet në nevojë, si dhe referimi te shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal e qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm<br>6. Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit<br>7. Mbikëqyrja në vazhdimësi e ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimi për përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar<br>8. Hedhja në Regjistrin Elektronik Kombëtar të të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, sipas përcaktimit të Nenit 29, pika 2 të Ligjit 121/2016<br>9. Aplikimi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.<br>10. Plotësimi në Platformën Digjitale të dhënat për çdo fëmijë të identifikuar në nevojë |
| **iv Aktivitetet kryesore të projektit**<br><br>1. Nxjerrja e një Urdhëri nga Kryetari i Bashkisë për ngritjen e NJVNR në njësinë qendrore<br>2. Drejtoria e Shërbimit Social në bashkëpunim me Njësinë e Arsimit Parashkollor dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore ristrukturojnë burimet njerëzore (punonjësit social, administratorët shoqërorë, PMF, etj.) për të krijuar organogramën e NJVNR dhe punësuar punonjësit e nevojshëm;<br>3. Paraqitja e strukturës së NJVNR të çdo Njësie Administrative në Këshillin Bashkiak për miratimin e ndryshimeve strukturore dhe buxhetit të pagave të punonjësve të rinj. Lobimi në Këshillin Bashkiak për rëndësinë e NJVNR në Njësitë Administrative dhe miratimin në buxhet të pagave të punonjësve që do të nevojiten shtesë;<br>4. Pas miratimit nga KB, fillon ngritja e strukturës së NJVNR në Bashkinë Mirditë; |

| | |
|---|---|
| 5. Drejtoria e Shërbimit Social është përgjegjëse për ngritjen e këtyre strukturave. | |
| **b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**<br><br>1. Ngritja e NJVNR në NjA Rrëshen dhe Rubik;<br>2. Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti me nevojë për përfshirje sociale;<br>3. Trajtimi në mënyrë efikase i çdo rasti të identifikuar. | |
| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)<br><br>• Drejtoria e Shërbimit Social<br>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore<br>• Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
| e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv) | |
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2024 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Sektori i ndihmës ekonomike dhe të drejtave sociale pranë ASHSAK |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 014 | **Projekti**: Ngritja e skuadrave të terrenit për identifikimin në mënyrë proaktive të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale në komunitet dhe fëmijëve në situatë rruge | **Programi Buxhetor:** 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët<br><br>**Funksioni:** 10 |
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Në Bashkinë e Mirditës në Njësinë Administrative Rrëshen, janë të emëruar 3 administartorë socialë ndërkohë në njësitë e tjera, shpërndarja është në këtë formë:<br><br>• Njësia Administrative Rubik, 3 administratorë social.<br>• Njësia Administrative Orosh, 1 punonjës social.<br>• Njësia Administrative Fan, 2 punonjës social.<br>• Njësia Administrative Kthellë, 1 punonjës social.<br>• Njësia Administrative Kaçinar, 1 punonjës social. | | |

| |
|---|
| • Njësia Administrative Selitë, 1 punonjës social. |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje |
| Sipas Ligjit 121/2016 *"Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"*, bashkia duhet të ketë struktura të ngritura në dy nivele:<br><br>1. Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në bashki;<br>2. Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit, e krijuar në nivelin e njësive administrative.<br><br>Në 1,037 fëmijë të identifikuar në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje përqindjen më të lartë e zenë fëmijët e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike (81% e rasteve) , si dhe fëmijët me aftësi të kufizuara (17% e rasteve). Nga këta fëmijë, nuk dihet se sa prej tyre janë të regjistruar në kopsht. Bashkia i identifikon fëmijët me nevojë për përfshirje sociale nëpërmjet raportimit të stafit të shkollave dhe kopshteve, familjeve që marrin ndihmë ekonomike dhe familjet që kanë anëtarë me aftësi të kufizuar, dhe momentalisht nuk ka një numër të saktë të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti. |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>Identifikimi proaktiv synon të kryejë vëzhgim të rregullt të fëmijës, mbledhje informacioni, informim për alternativa të mundshme, referim rasti brenda 24 orëve dhe në kushtet e nivelit të rrezikut të lartë ka si referencë VKM 578, i cili rregullon procedurat e menaxhimit të rastit. Nëpërmjet këtyre procedurave, fëmijët e identifikuar në nevojë për mbështetje dhe trajtim, raportohen edhe si fëmijë, të cilët duhet të referohen pranë shërbimeve konkrete për përfshirje sociale. |
| **iii Niveli i ndërhyrjes**<br>**A: Ligjore**<br><br>1. Miratimi i buxhetit për shpenzimet e Grupeve të Terrenit gjatë punës së tyre nga KB.<br><br>**B: Menaxheriale**<br><br>1. Bashkia, nëpërmjet strukturës së Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, ngre grupet e skuadrave të terrenit. Skuadrat e terrenit përbëhen nga PMF dhe administratorët shoqërorë deri në vitin 2026. Pas vitit 2026, me ngritjen e NJVNR pranë çdo NJA, pjesë e grupeve të terrenit do të jenë PMF dhe punonjësit socialë.<br>2. Drejtoria e Shërbimit Social harton dhe miraton planin e punës së ekipeve, të cilat identifikojnë në mënyrë proaktive në terren fëmijët e shfrytëzuar ekonomikisht, ku përfshihen edhe fëmijët në situatë rruge. Gjithashtu, vlerëson shpenzimet operative mujore për çdo grup terreni (kostot e transportit, dieta, etj.)<br>3. Ngritja e skuadrave të terrenit nuk është e lidhur domosdoshmërisht me funksionimin e NJVNR. Pjesë të skuadrave të terrenit mund të jenë punonjësit social pranë DNESHS |

(Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe të Shëbimeve Sociale), punonjës të qendrave komunitare dhe punonjës të organizatave me të njëjtin fokus, vullnetarë nga komuniteti, etj.

4. Identifikimi në mënyrë proaktive në terren i fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, ku përfshihen edhe fëmijët në situatë rruge;
5. Raportimi i rasteve te Drejtoria e Shërbimeve Sociale/ NJVNR për të ofruar trajtimin e tyre;
6. Plotësimi i Platformës Digjitale për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale dhe situatë rruge për të krijuar një databazë të saktë nga Drejtoria e Shërbimit Social.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Miratimi në KB i buxhetit për shpenzimet operative të grupeve të terrenit;
2. Ngritja e grupeve të terrenit nga Drejtoria e Shërbimit Social, hartimi i planit të punës dhe ndarja e ekipeve;
3. Kryerja e vizitave periodike në terren nga Skuadrat e Terrenit.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Identifikimi i të gjithë fëmijëve në situatë rruge dhe në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti;
2. Krijimi i databazës me të dhëna të këtyre fëmijëve dhe ecurinë e rastit të tyre.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Drejtoria e Shërbimit Social;<br>• NJVNR | • OJF; |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Miratimi në KB i shpenzimeve operative të grupeve të terrenit | Drejtoria e Shërbimit Social | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Ngritja e Grupeve të Terrenit | Drejtoria e Shërbimit Social | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Kryerja e vizitave në terren | Drejtoria e Shërbimit Social | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2024 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Sektori i ndihmës ekonomike dhe të drejtave sociale pranë ASHSAK |

*Risqet*

| **Risku** | **Mitigimi** |
|---|---|
| Bashkia e Mirditës për arsye financiare mund të mos prioritizojë ngritjen e NJVNR. | Pavarësisht kufizimeve financiare, do të lobohet që NJVNR të ngrihet. Nëse KB nuk e miraton atëherë do të shihet mundësia e financimit nëpërmjet donatorëve të ndryshëm. |

### 3.3.2 Ndihma e përditshme

*Informacion i përgjithshëm*

Referuar të dhënave të mbledhura nga Bashkia Mirditë, numri i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale të regjistruar në kopshtet publike të bashkisë është 54 (2 Egjiptianë + 2 Romë + 51 me ndihmë ekonomike). Për të identifikuar fëmijët në nevojë për përfshirje sociale, Specialistët e qendrave komunitare Për Familjen" mbulojnë te gjitha lagjet e qytetit të Rrëshenit dhe kanë filluar të shtrihen gradualisht edhe në Njësitë Administrative Rubik.

*Objektiva kryesore:*

Përmirësimi i trajtimit të rasteve të fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët jetimë, me prindër të divorcuar, etj);

*Nën-objektivat:*

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | Hartimi dhe ofrimi i paketës së shërbimeve për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti në mënyrë që të nxitet regjistrimi/frekuentimi i tyre në kopsht |

*Lista e projekteve*

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 015 | **Projekti**: Ofrimi i paketave lehtësuese për fëmijët në nevojë | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Në tërësi për kopshtet në Bashkinë Mirditë, nuk ka masa lehtësuese financiare që të mundësojnë aksesin e fëmijëve të familjeve më në nevojë në to. | | |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje | | |
| Referuar të dhënave, numri i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale të regjistruar në kopshtet publike të bashkisë është 54 (2 Egjiptianë + 2 Romë + 51 me ndihmë ekonomike).<br>Deri tani Bashkia Mirditë, nuk ka ofruar asnjë paketë apo masë lehtësuese për fëmijët në nevojë. | | |

| |
|---|
| |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>Për të rritur frekuentimin në kopshte të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale (rom, egjiptian, fëmijë që vijnë nga familje të asistuara me ndihmë ekonomike), me aftësi të kufizuar dhe në nevojë për mbrojtje është e nevojshme që të ofrohen paketa lehtësuese për prindërit e fëmijëve. Një prej këtyre paketave është regjistrimi i fëmijëve në kopshte me drekë pa pagesë.<br><br>Kjo nismë jo vetëm që rrit normën e frekuentimit të fëmijëve që janë tashmë të regjistruar në kopshtet publike të Bashkisë Mirditë, por gjithashtu nxit prindërit, që nuk i kanë regjistruar më parë fëmijët në kopsht për t'i regjistruar. Në këtë mënyrë, rritet norma e regjistrimit të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje ose me aftësi të kufizuar në kopsht. |
| **iii Niveli i ndërhyrjes**<br>**A: Ligjore**<br><br>1. Miratimi në KB i paketës lehtësuese për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale dhe mbrojtje dhe fëmijët me aftësi të kufizuar.<br><br>**B: Menaxheriale**<br><br>1. Hartimi i paketës lehtësuese nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës në bashkëpunim me Qendrën Ekonomike. Në paketë përfshihet numri i fëmijëve që do të përfitojnë nga ky shërbim, kopshtet në të cilat do të regjistrohen dhe kostot mujore për fëmijë;<br>2. Identifikimi i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi të kufizuar nëpërmjet Platformës Digjitale;<br>3. Regjistrimi i fëmijëve në kopshtet me drekë pa pagesë. |
| **iv Aktivitetet kryesore të projektit**<br><br>1. Hartimi i paketës lehtësuese;<br>2. Miratimi i paketës lehtësuese në KB;<br>3. Zbatimi i paketës lehtësuese. |
| **b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**<br><br>1. Rritja e frekuentimit në kopsht të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi të kufizuar;<br>2. Rritja e regjistrimit të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi të kufizuar. |

| | |
|---|---|
| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)<br><br>• Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës;<br>• Qendra Ekonomike | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2023 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Hartimi i paketës lehtësuese | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Miratimi i paketës lehtësuese në KB | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Zbatimi i paketës lehtësuese | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | | | | |
| | | | | | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2024 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

*Risqet*

| Risku | Mitigimi |
|---|---|
| Mungesa e fondeve për të miratuar paketat lehtësuese. | Lobimi në KB për të miratuar paketat lehtësuese duke i njohur me përfitimet që sjellin këto paketa. |

| Risku | Mitigimi |
|---|---|
| Pamundësia për ngritjen e Grupeve të Terrenit vështirëson identifikimin e fëmijëve potencialisht përfitues nga këto paketa. | Asistimi i Bashkisë në ngritjen e strukturave si NJVNR dhe Grupet e Terrenit. |

## 3.4 Mbrojtja e fëmijëve

### 3.4.1 Identifikimi i abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës

*Informacion i përgjithshëm*

Në Bashkinë Mirditë ka të punësuar 3 administratorë shoqërorë dhe 1 PMF në NjA Rrëshen. Ndërkaq, në Njësitë e tjera Administrative ka të punësuar punonjës social ku 3 prej tyre ndodhen në Njësinë Administrative Rubik, 2 në Njësinë Administrative Fan, 1 në Njësinë Administrative Orosh, 1 në Njësinë Administrative Kthellë, 1 në Njësinë Administrative Kaçinar dhe 1 në Njësinë Administrative Selitë.

Nuk ka patur raste të identifikimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në kopshtet e Bashkisë Mirditë. Cdo rast i identifikuar në nevojë për mbrojtje duhet të raportohet pranë NJMF. Kopshtet nuk kanë një person të caktuar si person përgjegjës për të asistuar punonjësit për raportimin e rasteve të identifikuara dhe koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

*Objektiva kryesore:*

Parandalimi, identifikimi, raportimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

*Nën-objektivat:*

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve punojnë ngushtësisht me stafet e kopshteve për parandalimin, identifikimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve nëpëmjet GTN (grupeve teknike ndërsektoriale) për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve por edhe trajtimin në vazhdimësi të tyre |
| 2 | Organizimi i paketave trajnuese për stafet e punonjësve për t'u njohur me shërbimet mbrojtëse për fëmijët dhe kryesisht të rolit të tyre në të gjithë këtë proces |

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 3 | Vendosja e PMF në kontakt me stafin e kopshteve në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve |
| 4 | Çdo kopsht ka të hartuar, të miratuar dhe të njohur nga stafet, politikat e mbrojtjes së fëmijëve |

*Lista e projekteve*

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 016 | **Projekti**: Shtimi i një psikologu në Njësinë e Arsimit Parashkollor | **Programi Buxhetor:** 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët<br><br>**Funksioni:** 10 |
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br>Në Bashkinë e Mirditës aktualisht ka nje psikolog në qendrën kulturore të fëmijëve si dhe një psikolog tjeter në NjA Rrëshen. Pra janë dy psikologë në total, dhe kanë nevojë për një ristrukturim. Ndërkohë personi i emëruar si PMF në Bashki, është edhe psikolog me profil. Pavarsisht faktit se një psikolog, është i emëruar pranë qendrës kulturore, pranë ASHSAK në sektorin e arsimit nuk ka një psikolog të dedikuar. | | |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje | | |
| Duke i dhënë fokus trajtimit të problematikave të fëmijëve si parandalim në moshën e hershme, është e nevojshme që të ketë punonjës të dedikuar për trajtimin e problematikave psiko-sociale për fëmijët në moshë kopshti në strukturën e Njësisë së Arsimit Parashkollor.<br><br>Për të patur një ofrim të duhur të shërbimit psikosocial do të ishte mire që psikologët ekzistues, të ristrukturoheshin Brenda strukturës ekzistuese për kopshtet dhe tu vinin në ndihmë të gjithë fëmijëve në nevojë për këtë shërbim. | | |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>Nëpërmjet punësimit apo ristrukturimit të psikologëve ekzistues, do të trajtohen më mirë problematikat psiko-sociale të fëmijëve. Psikologët përveçse duhet të ofrojnë mbështetje psiko-sociale synohet që njëkohësisht të raportojnë pranë PMF-së, rastet e fëmijëve në rrezik për abuzim të identifikuar gjatë trajtimit. Kështu synohet të:<br><br>1. Ofrohet shërbim cilësor dhe profesional i dedikuar për fëmijët në moshë kopshti;<br>2. Mbulim më i mirë i nevojave të fëmijëve që kanë nevojë për trajtim; | | |

<table>
<tr><td colspan="2">

3. Rritja e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përfshirje sociale.

</td></tr>
<tr><td colspan="2">

**iii Niveli i ndërhyrjes**
**A: Ligjore**

1. Propozimi pranë KB për punësimin apo ristrukturimin e psikologëve të dedikuar për fëmijët e kopshteve;
2. Miratimi nga KB i buxhetit të nevojshëm.
3. Kontratë pune mes Bashkisë dhe Psikologëve.

**B: Menaxheriale**

1. Drejtoria e Shërbimit Social në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore punëson psikologët sipas procedurave të brendshme;
2. Psikologët e dedikuar për kopshtet hartojnë planet e punës, vizitat në terren, këshillimin dhe trajtimin e rasteve të identifikuara të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale dhe vizita dhe takime me fëmijët e kopshteve për të vlerësuar nevojat e tyre psiko-sociale.

</td></tr>
<tr><td colspan="2">

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Propozimi në KB për punësim psikologësh të rinj apo ristrukturim të psikologëve ekzistues.
2. Paga për 1 psikolog është 48 mijë lekë, bazuar në Vendim Nr. 133/2018, *“Miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2019”*.
3. Vizita në terren nga psikologët për vlerësimin psiko-social të fëmijëve dhe trajtimin e rasteve të identifikuara të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale. Buxheti për vizitat në terren është vlerësuar sa kostoja vjetore e pagës së 2 psikologëve.

</td></tr>
<tr><td colspan="2">

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Rritje e numrit të fëmijëve që marrin shërbime;
2. Rritje e numrit të fëmijëve të raportuar pranë PMF;
3. Rritje e numrit të fëmijëve që marrin shërbime të specializuara sipas nevojave;
4. Çdo fëmijë që frekuenton kopshtin dhe merr trajtim psikosocial, ka dosjen e vet individuale, ku përfshihen praktika e vlerësimit dhe planit të ndërhyrjes.

</td></tr>
<tr><td>

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Shërbimit Social

</td><td>

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF

</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| • Drejtoria e burimeve njerezore | |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Propozimi në KB | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Punësimi/ Ristrukturimi i psikologëve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 489.60 | 489.60 | 489.60 | 1467 |
| 3 | Vizita në terren nga psikologët për vlerësimin psiko-social të fëmijëve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 489.60 | 489.60 | 489.60 | 1467 |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2024 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Sektori i ndihmës ekonomike dhe të drejtave sociale pranë ASHSAK |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 017 | **Projekti**: Vendosja dhe promovimi i një punonjësi të dedikuar në çdo institucion të arsimit parashkollor i cili do të kujdeset për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucion | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |

**a)Përshkrim i shkurtër i projektit**

**i Situata**

Kopshtet në Bashkinë e Mirditës që ndodhen në godinat e shkollave, menaxhohen nga drejtuesit e shkollave të arsimit bazë. Vetëm 2 kopshte në qytetin e Mirditës kanë drejtues më vete.

| |
|---|
| Është me rëndësi që në çdo kopësht një staf mësues apo përgjegjes të jetë më tepër i vëmendshem për çështjet e mbrojtjes se fëmijëve dhe të njohë procedurën e identifikimit dhe raportimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve. |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje |
| Është e nevojshme që stafi i kopshteve të njihet me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe mënyrat e identifikimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Gjithashtu, është e rëndësishme që stafi të jetë i njohur me mënyrën e referimit të çdo rasti të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në Bashki.<br><br>Për këtë qëllim është e nevojshme që të paktën një staf i kopshteve të ketë njohuritë e duhura për identifikimin dhe raportimine e rasteve të fëmijëve në rrezik apo në nevojë për mbrojtje që frekuentojnë kopshtin ashtu sikundër ndjek rastet e fëmijëve të regjistruar në kopsht dhe që janë identifikuar dhe në ndjekje nga PMF. |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>Për të rritur numrin e fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje dhe për të siguruar trajtimin e çështjes së tyre në mënyrë efikase është e rëndësishme që stafi i kopshtit të njihet me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të vendoset një person kontakti në çdo kopsht, që do të jetë përgjegjës për zbatimin e saj (për tu njohur me kanalet e raportimit dhe identifkimit dhe përgjegjësitë që ju takon sipas ligjit). |
| **iii Niveli i ndërhyrjes**<br><br>**A: Menaxheriale**<br><br>1. Çdo kopsht nën administrimin e Njësisë së Arsimit Parashkollor vendos personin e kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve;<br>2. Të dhënat e Personave të Kontaktit dërgohen pranë Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve të Bashkisë dhe PMF të NJA menjëherë pas aprovimit zyrtar të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës;<br>3. Personi i Kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve në kopsht bëhet pjesë e mekanizmit të identifikimit dhe menaxhimit të rasteve;<br>4. Roli i këtij personi është të shërbejë si një pikë kontakti, dhe të këshillojë, mbështesë dhe ndihmojë stafetnë kopshte dhe çerdhe në zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve;<br>5. Personi i kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve në kopsht është burimi i parë i këshillimit dhe përkrahjes në lidhje me çështjet për mbrojtjen e fëmijëve dhe zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve;<br>6. Bashkia do të vërë në dispozicion informacion të vazhdueshëm dhe profesional për kopshtet dhe çerdhet për mbrojten e fëmijëve; |

7. Organizimi i trajnimeve të veçanta për Personat e Kontaktit për të rritur kapacitetet e tyre mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve. Trajnimet organizohen nga PMF.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Përcaktimi i Personit të Kontaktit nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës;
2. Dërgimi i të dhënave të Personit të Kontaktit në NJMF në Bashki dhe PMF në NJA;
3. Organizimi i trajnimit të Personave të Kontaktit nga drejtuesit e kopshteve (të trainuar më parë nga NJMF) për rritjen e kapaciteteve mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Rritja e numrit të fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje.
2. Rritje e kapaciteteve të stafit të kopshteve në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve.
3. Menaxhimi efikas i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Drejtoria e Shërbimit Social (NJMF, PMF)<br>• Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | • OJF |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Përcaktimi i Personit të Kontaktit | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Dërgimi i të dhënave te NJMF | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Trajnimi i Personave të Kontaktit | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2024 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 018 | **Projekti**: Hartimi i një dokumenti mbi politikat e mbrojtjes së fëmijëve përshtatur me gjuhën e kuptueshme për fëmijët e kopshteve dhe stafeve pedagogjike ne kopshte | **Programi Buxhetor:** 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët<br><br>**Funksioni:** 10 |
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Ligji Nr. 18/2017 "*Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës",* përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.<br><br>Ligji shpreh qartëisht mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës në të gjitha format dhe mënyrat dhe dokumenti i politikave të mbrojtjes së fëmijëve garanton që në të gjitha sistemet dhe atë të sistemit të arsimit parashkollor të jetë i familjarizuar më të gjitha praktikat dhe procedurat për parandalimin e formave të abuzimit, identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, raportimin dhe trajtimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje. | | |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje | | |
| Zinxhiri i komunikimit mes kopshtit dhe Bashkisë nuk është i qartë në kopshtet që menaxhohen nga drejtorët e shkollave të arsimit bazë. Gjithashtu, një pjesë e këtyre kopshteve kanë vetëm 1 mësuese të punësuar, e cila menaxhon vetëm një grup të përzier me mosha të ndryshme fëmijësh, çka vështirëson akoma më shumë komunikimin kopësht-bashki.<br><br>NJMF pranë Drejtorisë së Shërbimit Social dhe PMF duhet të sigurohen që ligji 18/2017 është i qartë dhe i kuptueshëm për të gjithë stafin e kopshteve dhe bashkisë që janë në kontakt me fëmijët. Për këtë arsye, është e nevojshme të hartohet një dokument bazuar në këtë ligj mbi politikat e mbrojtjes së fëmijëve, të përshtatur në gjuhë të kuptueshme jo vetëm për stafin e kopshteve, por edhe për vetë fëmijët, prindërit dhe partnerë të tjerë. | | |

**ii Synimi i projektit**

Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të jetë një dokument udhëheqës për stafet, prindërit, partnerët e vullnetarët në institucionet edukative parashkollore nën administrimin e bashkive në të cilat punohet me / për fëmijë, për të mbrojtur dhe ruajtur mirëqënien e fëmijëve nga çdo formë e dhunës apo abuzimit.

Ky dokument synon të nxisë garantimin e një sjelljeje institucionale, më të përgjegjshme në kopshtet dhe jo vetëm në bashki në funksion të krijimit të ambjenteve më të sigurta për të gjithë fëmijët.

Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve ka udhëzime dhe procedura të qarta të cilat do t'i ndihmojnë stafet kopshteve në identifikimin e rasteve të abuzimit në mjediset e institucionit si dhe raportimin apo referimin e çdo rasti të abuzimit të fëmijëve. Këto procedura duhet të jenë të qarta edhe për bordet drejtuese dhe këshillin e prindërve.

Rëndësia e kësaj politike shtrihet në qartësimin e roleve, përgjegjësive, procedurave dhe rregullave për shqetësime që dalin lidhur me mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu, ajo do të ndihmojë kopshtet të përmbushin detyrimet ligjore lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.

**iii Niveli i ndërhyrjes**

**A: Ligjore**

1. Miratimi i dokumentit mbi Politikat e Mbrojtjes së Fëmijës në Këshillin Bashkiak;
2. Ky dokument bëhet pjesë e kontratës së çdo mësuesi, ku këta të fundit nënshkruajnë për kuptueshmërinë e tij dhe mbajnë përgjegjësi për të.

**B: Menaxheriale**

1. Drejtoria e Shërbimit Social, NJMF dhe PMF dhe në bashkëpunim me ZVAP dhe/ose OJF të profilizuara në fushën e arsimit ngre grupin e punës për përgatitjen e dokumentit, duke u përkujdesur që të përfshijë dhe specifika që lidhen me kulturën dhe kontekstin e secilës zonë;
2. Kryhen konsultime me mësues dhe prindër për të finalizuar më pas dokumentin.
3. Dokumenti kalon për miratim në KB;
4. Pjesë e dokumentit është kodi i sjelljes së çdo punonjësi që është në kontakt me fëmijën, si praktikantë, vullnetarë, mësues, etj;
5. Vendoset personi i kontaktit në çdo kopsht për mbrojtjen e fëmijëve duke përcaktuar rolin dhe përgjegjësitë e tij (Projekt fisha nr 014);
6. Hartohen procedurat për raportimin e shqetësimeve dhe incidenteve për mbrojtjen e fëmijëve;
7. Hartimi i një aneksi brenda dokumentit për sjelljen dhe trajtimin që duhet të ketë media në çështje që lidhen me fëmijët.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Ngritja e Grupit të Punës për hartimin e dokumentit;
2. Konsultimi me prindër dhe mësues;
3. Miratimi në KB;
4. Promovimi i dokumentit në të gjitha strukturat e nevojshme;
5. Informim i stafit të kopshtit për politikat e mbrojtjes së fëmijëve

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Hartimi i dokumentit mbi Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve;
2. Njohja më e mirë e stafit të kopshteve, prindërve dhe fëmijëve me Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve;
3. Pajisja e çdo kopshti me një praktikë të miratuar ligjore të përshtatur sipas grupmoshës së fëmijëve në kopsht që siguron mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Drejtoria e Shërbimit Social (NJMF, PMF) | • OJF |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ngritja e Grupit të Punës | Sektori i ndihmës ekonomike dhe të drejtave sociale pranë ASHSAK | | | | | |
| 2 | Konsultimi me prindër dhe mësues | Sektori i ndihmës ekonomike dhe të drejtave sociale pranë ASHSAK | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Miratimi në KB | Sektori i ndihmës ekonomike dhe të drejtave | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | sociale pranë ASHSAK | | | | | |
| 4 | Promovimi i dokumentit në të gjitha strukturat e nevojshme | Sektori i ndihmës ekonomike dhe të drejtave sociale pranë ASHSAK | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Informim i stafit të kopshtit për politikat e mbrojtjes së fëmijëve | Sektori i ndihmës ekonomike dhe të drejtave sociale pranë ASHSAK | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:** 2024 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:** Sektori i ndihmës ekonomike dhe të drejtave sociale pranë ASHSAK |

### 3.4.2 Shërbimi bashkiak i mbrojtjes së fëmijës

*Informacion i përgjithshëm*

Në Bashkinë Mirditë ka të punësuar 3 administratorë shoqërorë dhe 1 PMF në NjA Rrëshen. Ndërkaq, në Njësitë e tjera Administrative ka të punësuar punonjës social ku 3 prej tyre ndodhen në Njësinë Administrative Rubik, 2 në Njësinë Administrative Fan, 1 në Njësinë Administrative Orosh, 1 në Njësinë Administrative Kthellë, 1 në Njësinë Administrative Kaçinar dhe 1 në Njësinë Administrative Selitë.

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe shërbimi psikosocial janë njësi me shumë rëndësi për parandalimin, identifikimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në moshë për kopsht. Është me rëndësi që këto dy struktura të jenë funksionale dhe ndërveprojnë ngushtë për çdo fëmijë të identifikuar në nevojë për mbrojtje që frekuenton kopshtin.

Bashkia ka në strukturën e saj një Grup Teknik Ndërsektorial për të trajtuar çështjet e përfshirjes sociale, fëmijëve në nevojë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara. Bashkia është pjesëmarrëse dhe koordinuese e GTN dhe sipas çështjeve/ problematikave ftohen të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme, si SSHS, ZAV, NJVKSH, Policia e Shtetit dhe të OSHC, etj. Gjatë vitit të kaluar, GTN ka trajtuar 1 çështje dhe kjo strukturë ngrihet sa herë është e nevojshme për të trajtuar raste.

*Objektiva kryesore:*

Shërbimi cilësor në kopshte që garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në çdo kohë, jo vetëm gjatë raportimit, por përgjatë gjithë kohëqëndrimit në kopësht të fëmijës.

*Nën-objektivat:*

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve punojnë ngushtësisht me stafet e kopshteve për parandalimin, identifikimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve nëpëmjet GTN (grupeve teknike ndërsektoriale) për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve por edhe trajtimin në vazhdimësi të tyre |

*Lista e projekteve*

| **Nr.** 019 | **Projekti**: Promovimi i rolit dhe detyrave te PMF | **Programi Buxhetor:** 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët<br><br>**Funksioni:** 10 |
|---|---|---|
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Në Bashkinë Mirditë ka të punësuar 3 administratorë shoqërorë dhe 1 PMF në NjA Rrëshen. Ndërkaq, në Njësitë e tjera Administrative ka të punësuar punonjës social<br><br>Njohja e rolit dhe përgjegjësisë e PMF, shërbimet e tyre si dhe në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë në kopsht si pjesë e mekanizmit për mbrojtjen e fëmijëve është prioritare për të rritur mundësitë e një shërbimi cilësor në kopësht që garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në çdo kohë, jo vetëm gjatë raportimit, por përgjatë gjithë kohëqëndrimit në kopsht të fëmijës. | | |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje | | |
| Për shkak të mungesës së grupeve të terrenit proaktive për identifikimin e fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, identifikimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje ka qenë i vështirë.<br><br>Kështu, lind nevoja të promovohet roli i PMF në komunitet, në stafet akademike të kopshteve, etj. | | |
| **ii Synimi i projektit**<br>Stafi i kopshteve duhet të njihet me PMF, të trajnohen mbi mënyrat e identifikimit të rasteve të fëmijëve të dhunuar, të dinë si të referojnë rastin dhe të kuptojnë rolin që ka PMF për mbrojtjen e fëmijëve. Është e nevojshme të ndërtohet një urë komunikimi dhe mirëbesimi mes stafit të | | |

| |
|---|
| kopshteve dhe PMF, në mënyrë që identifikimi, referimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të jetë sa më efikas. |
| **iii Niveli i ndërhyrjes**<br>**A: Ligjore**<br><br>PMF si koordinues të grupeve teknike ndërsektoriale nxisin përfaqësimin e kopshteve nga një person kontakti i zgjedhur sipas VKM 149. Lind nevoja e njohjes se bazës ligjore që ngarkon te gjitha institucionet në kontakt me fëmijën të jetë pjesë e GTN.<br><br>**B: Menaxheriale**<br><br>1. NJMF dhe PMF organizojnë sesione informuese me stafin e Institucioneve arsimore të kopshteve, mbi rolin e tyre dhe mënyrën e adresimit të çështjeve të fëmijëve tek PMF.<br>2. Drejtuesit e kopshteve organizojnë sesione informuese me Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit dhe Komisionin e Shëndetit.<br>3. PMF në NJA kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara nga VKM Nr. 578, datë 3.10.2018, *"Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes"*. |
| **iv Aktivitetet kryesore të projektit**<br><br>1. Organizimi i takimeve informuese me stafin e kopshteve nga NJMF dhe PMF, me qëllim:<br>    1. Informimin mbi rolin e PMF,<br>    2. Diskutimin për çështje të mbrojtjes së fëmijëve, identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe mënyrën e adresimit të çështjes pranë PMF.<br>2. Organizimi i takimeve informuese me Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit, Komisionin e Shëndetit |
| **b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**<br><br>1. Çdo institucion arsimor duhet të jetë i njohur me rolin dhe përgjegjësitë e PMF-së;<br>2. Numri i telefonit të strukturave të Mbrojtjes së fëmijëve duhet të jetë i afishuar në ambinentet e kopshteve;<br>3. Çështje të mbrojtjes së fëmijëve diskutohen në mënyrë të vazhdueshme në bordin drejtues apo në këshillin e prindërve. |

| | |
|---|---|
| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |

- Drejtoria e Shërbimit Social – NJMF dhe PMF në NJA

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Takime informuese me drejtuesit e kopshteve | Njësia për mbrojtjen e fëmijëve | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Takime informuese me Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit dhe Komisionin e Shëndetit | Njësia për mbrojtjen e fëmijëve | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

**f) Periudha e zbatimit:**
2024

**g) Ndjek zbatimin e projektit:**
Sektori i ndihmës ekonomike dhe të drejtave sociale pranë ASHSAK

## 3.5 Fëmijët me aftësi të kufizuar

### 3.5.1 Adresimi i prindërve

*Informacion i përgjithshëm*

Në Bashkinë e Mirditës janë 18 fëmijë me aftësi të kufizuar. Nga këta fëmijë, vetëm 5 prej tyre janë të regjistruar në kopësht. Këta fëmijë janë me aftësi të kufizuara mendore dhe janë 2 vajza dhe 3 djem, të gjithë në Njësinë Administrative Rrëshen. Gjatë analizës së situatës së arsimit parashkollor është evidentuar se mësuesit e kopshteve hasin probleme me prindërit në momentin që ata dyshojnë se fëmija mund të jetë me aftësi të kufizuar. Prindërit nuk pranojnë të vizitojnë fëmijën e tyre sepse refuzojnë të pranojnë se mund të jetë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike.

Qëndresa që bëjnë prindërit kur dyshohet se fëmijët e tyre mund të jenë me aftësi të kufizuar vonon procesin e diagnostikimit të fëmijëve dhe trajtimin e tyre sa më parë. Për këtë arsye duhet ndërhyrë nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës dhe Shërbimi Psiko-Social për të punuar me këtë problem.

*Objektiva kryesore:*

Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar.

*Nën-objektivat:*

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | Përmirësimi i komunikimit mësues-prind gjatë diagnostikimit të fëmijës |

*Lista e Aksioneve*

| Numri | Projekti | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxhet Vit 2024 | Buxhet Vit 2025 | Buxhet Vit 2026 | Total periudhe |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 020 | Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të | Sektori i ndihmës ekonomike | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| Numri | Projekti | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxhet Vit 2024 | Buxhet Vit 2025 | Buxhet Vit 2026 | Total periudhe |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | fëmijëve me AK përmes mbështetjes psiko-sociale të prindërve dhe mësuesve | dhe të drejtave sociale pranë ASHSAK | | | | | |

*Lista e projekteve*

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 020 | **Projekti**: Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me AK përmes mbështetjes psiko-sociale të prindërve dhe mësuesve | **Programi Buxhetor:** 10140 - Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara<br><br>**Funksioni:** 10 |
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Në Bashkinë e Mirditës janë 5 fëmijë me aftësi të kufizuar që janë regjistruar në kopsht. Gjatë analizës së situatës së arsimit parashkollor është evidentuar se mësuesit e kopshteve hasin | | |

| |
|---|
| probleme me prindërit në momentin që ata dyshojnë se fëmija mund të jetë me aftësi të kufizuar. Prindërit nuk pranojnë të vizitojnë fëmijën e tyre sepse refuzojnë të pranojnë se mund të jetë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike. |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje |
| Qëndresa që bëjnë prindërit kur dyshohet se fëmijët e tyre mund të jenë me aftësi të kufizuar vonon procesin e diagnostikimit të fëmijëve dhe trajtimin e tyre sa më parë. Për këtë arsye duhet ndërhyrë nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës dhe Shërbimi Psiko-Social për të punuar me këtë problem. |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>Ky projekt synon rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve për rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe trajtimin e specializuar të fëmijës me aftësi të kufizuar dhe asistimin e mësuesve gjatë procesit të komunikimit me prindërit. |
| **iii Niveli i ndërhyrjes**<br>**A: Ligjore**<br><br>1. Miratimi i buxhetit për trajnimet e mësuesve në KB<br><br>**B: Menaxheriale**<br><br>1. Hartimi i planit të trajnimit të mësuesve të arsimit parashkollor mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind nga psikologët e Njësisë së Arsimit Parashkollor. Trajnimet mund të organizohen në nivel Njësie Administrative për mësuesit që punojnë në kopshtet që ndodhen në zonat rurale dhe në nivel rajoni për mësuesit e kopshteve që ndodhen në qytetin e Mirditës.<br>2. Trajnimet e organizuara në qytet nuk kanë kosto, ndërsa ato të organizuara në Njësitë Administrative kanë kostot e transportit;<br>3. Organizim i trajnimeve për mësuesit e arsimit parashkollor nga psikologët e Njësisë së Arsimit Parashkollor mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind;<br>4. Mësuesi njofton Njësinë e Arsimit Parashkollor në rast se has një problem me prindërit përsa i përket diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar;<br>5. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës vë në dispozicion një psikolog për të trajtuar problematikën e raportuar, duke komunikuar me prindërit dhe mësuesin. |
| **iv Aktivitetet kryesore të projektit**<br><br>1. Hartimi i planit të trajnimeve për mësuesit;<br>2. Miratimi i planit të trajnimeve në KB;<br>3. Organizim i trajnimeve për mësuesit mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind; |

4. Ofrimi i shërbimit psiko-social për prindërit që kanë vështirësi për të pranuar se fëmijët e tyre mund të jenë me aftësi të kufizuara.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Përshpejtim i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës;<br>• Drejtoria e Shërbimit Social. | • OJF; |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Hartimi i planit të trajnimit të mësuesve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Miratimi i planit të trajnimit të mësuesve në KB | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Organizim i trajnimeve për mësuesi | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Ofrimi i shërbimit psiko-social për prindërit | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2024 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:** |
|---|---|

| | |
|---|---|
| | Sektori i ndihmës ekonomike dhe të drejtave sociale pranë ASHSAK |

### 3.5.2 Kërkesa për fonde shtesë

*Informacion i përgjithshëm*

Ndërkohë që numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar të regjistruar në kopsht është 5, infrastruktura e kopshteve nuk është e përshtatshme fëmijët me aftësi të kufizuar. Në ndërtesat e kopshteve mungojnë rampat. Edhe pse mund të jetë gjetur një zgjidhje provizore, është e nevojshme që në kopshte të vendosen rampat, në përputhje me standardin për infrastrukturën e kopshteve.

*Objektiva kryesore:*

Plotësimi i standardeve të aksesueshmërisë të fëmijëve me AK në arsimin parashkollor.

*Lista e projekteve*

| **Nr.** 021 | **Projekti**: Vendosja e rampave dhe respektimi i standardeve për infrastrukturën e fëmijëve me AK pranë institucioneve arsimore | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |
|---|---|---|
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Në Bashkinë e Mirditës numri i fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të regjistruar në kopsht është 5 fëmijë dhe numri total i mësueseve ndihmëse është 1. Në kopshtet e kësaj Bashkie nuk ka rampa dhe tualtete të përshtatshme për fëmijët me AK përvec kopshtit të NjA rrëshen i cili ka një tualet të përshtatshëm për këta fëmijë. | | |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje | | |
| Ndërkohë që numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar të regjistruar në kopësht është 5, infrastruktura e kopshteve nuk është e përshtatshme fëmijët me aftësi të kufizuar. Në ndërtesat e kopshteve mungojnë rampat. Edhe pse mund të jetë gjetur një zgjidhje provizore, është e | | |

| |
|---|
| nevojshme që në kopshte të vendosen rampat, në përputhje me standardin për infrastrukturën e kopshteve. |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>Synimi i këtij projekti është pajisja e gjithë ndërtesave të kopshteve me rampa për të lehtësuar aksesueshmërinë e fëmijëve me aftësi të kufizuar në kopsht. Në Bashkinë Mirditë janë gjithsej 17 kopshte publike për t'u pajisur me rampa.<br><br>Në VKM nr. 1074, datë 23.12.2015, *"Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara",* përcaktohen masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohen pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. |
| **iii Niveli i ndërhyrjes**<br>**A: Ligjore**<br><br>1. Miratimi në KB i buxhetit për vendosjen e rampave në kopshte;<br>2. Firmosja e kontratës mes Bashkisë dhe Operatorit/ëve ekonomik.<br><br>**B: Menaxheriale**<br><br>1. Hartimi i planit të ndërhyrjes për vendosjen e rampave në kopshte nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Njësinë e Arsimit Parashkollor. Plani do të përmbajë shtrirjen kohore të ndërhyrjes, kopshtet që do të vendosen rampa çdo vit dhe kostot;<br>2. Hapja e procedurës së prokurimit publik për gjetjen e operatorit ekonomik për vendosjen e rampave.<br><br>**C: Infrastrukturore**<br><br>1. Vendosja e rampave në kopshte nga operatori ekonomik. |
| **iv Aktivitetet kryesore të projektit**<br><br>1. Hartimi i planit të ndërhyrjes për vendosjen e rampave në kopshte nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Njësinë e Arsimit Parashkollor;<br>2. Miratimi në KB i buxhetit për vendosjen e rampave në kopshte; |

3. Hapja e procedurës së prokurimit publik dhe gjetja e operatorit ekonomik për vendosjen e rampave;
4. Vendosja e rampave në kopshte nga operatori ekonomik.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Të gjithë kopshtet kanë rampa në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuar të aksesojnë lehtësisht kopshtin.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
- Njësia e Prokurimit Publik

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF
- Operator/ët ekonomik

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Hartimi i planit | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Miratimi në KB i buxhetit | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Hapja e procedurës së prokurimit publik | Njësia e Prokurimit Publik | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Vendosja e rampave në kopshte nga operatori ekonomik | Operatori/ët ekonomik | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2024 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

*Risqet*

| Risku | Mitigimi |
|---|---|
| Mungesa e fondeve për të financuar këtë projekt rrezikon realizimin e tij | Përpjekja për të gjetur donatorë |

### 3.5.3 Ndihma e përditshme

*Informacion i përgjithshëm*

Në kopshtet publike të Bashkisë Mirditë janë regjistruar 5 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe ka 1 mësues ndihmës të punësuar. Për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara të regjistruar në kopshte, janë hartuar Programet Edukative Individuale (PEI) dhe Programet Individuale Mbrojtëse.

*Objektiva kryesore:*

Përmirësimi i procesit trajtimit të fëmijëve me AK.

*Nën-objektivat:*

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | Ndjekja e ecurisë së fëmijës me AK që nga momenti i diagnostikimit dhe plotësimi i nevojave të tij |

*Lista e Aksioneve*

| Numri | Projekti | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxhet Vit 2024 | Buxhet Vit 2025 | Buxhet Vit 2026 | Total periudhe |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 022 | Ngritja e Komisionit të Zakonshëm | Sektori i ndihmës ekonomike dhe të drejtave | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| Numri | Projekti | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxhet Vit 2024 | Buxhet Vit 2025 | Buxhet Vit 2026 | Total periudhe |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | pranë kopshteve | sociale pranë ASHSAK | | | | | |

*Lista e projekteve*

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 022 | **Projekti**: Ngritja e Komisionit të Zakonshëm pranë kopshteve | **Programi Buxhetor:** 10140 - Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara<br><br>**Funksioni:** 10 |
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Në kopshtet publike të Bashkisë Mirditë janë regjistruar 5 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe ka 1 mësues ndihmës të punësuar. Për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara të regjistruar në kopsht janë hartuar Programet Edukative Individuale (PEI) dhe Programet Individuale Mbrojtëse. | | |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje | | |
| Sipas Urdhërit Nr. 31, datë 28.01.2020, *“Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”*, përcaktohet se në kopshtet që ka fëmijë me aftësi të kufizuar të regjistruar, drejtuesi i kopshtit ngre Komisionin për fëmijë me AK, në përbërje të të cilit janë:<br><br>• 3 mësues;<br>• Psikologu/punonjësi social.<br><br>Në Komision merr pjesë të paktën një nga mësuesit e fëmijës me AK dhe mësuesi ndihmës (kur ka). Kryetari i Komisionit është punonjësi social/psikologu. | | |
| **ii Synimi i projektit** | | |

| |
|---|
| Ky projekt synon ngritjen e Komisionit të Zakonshëm në kopshtet ku ka fëmijë me aftësi të kufizuara dhe përcaktimin e një rregulloreje për mënyrën e ngritjes së Komisionit të Zakonshëm për t'u themeluar në çdo kopsht në momentin që regjistrohet/identifikohet një fëmijë me AK. |
| **iii Niveli i ndërhyrjes**<br>**A: Ligjore**<br><br>1. Drejtoria e Shërbimit Social harton një rregullore për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Zakonshëm në kopshte që kanë fëmijë me AK, bazuar në Urdhërin nr. 31. Rregullorja përmban:<br>o Mënyrën e ngritjes së Komisionit të Zakonshëm;<br>o Mënyrën si mblidhet Komisioni;<br>o Mënyrën e raportimit.<br><br>**B: Menaxheriale**<br><br>1. Drejtoria e Shërbimit Social u dërgon rregulloren të gjithë drejtuesve të kopshteve;<br>2. Drejtuesit e kopshteve zbatojnë rregulloren dhe ngrenë Komisionin e Zakonshëm;<br>3. Komisioni i Zakonshëm merret me:<br>o Udhëzon mësuesit për hartimin e PEI-ve dhe i miraton ato;<br>o Ndihmon mësuesit gjatë zbatimit të PEI-ve;<br>o Ndjek ecurinë e fëmijëve me AK;<br>o Paraqet në ZVA raportin e ecurisë së fëmijës me AK sipas formatit të vendosur nga Komisioni i ZVA-së.<br>4. Komisioni Multidisiplinor i dërgon Komisionit të Zakonshëm formatin e raportimit të ecurisë së fëmijës;<br>5. Komisioni i Zakonshëm raporton edhe në Drejtorinë e Shërbimit Social në Bashki për ecurinë e fëmijës. |
| **iv Aktivitetet kryesore të projektit**<br><br>1. Hartimi i rregullores për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Zakonshëm;<br>2. Ngritja e Komisionit të Zakonshëm në të gjithë kopshtet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të regjistruar. |
| **b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**<br><br>1. Zbatimi i PEI;<br>2. Ndjekja hap pas hapi e ecurisë së fëmijëve me AK;<br>3. Zgjidhja më shpejt e problematikave që mund të dalin. |

| | |
|---|---|
| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)<br><br>• Drejtoria e Shërbimit Social | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)<br><br>• ZVAP |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Hartimi i rregullores | Drejtoria e Shërbimit Social | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Ngritja e Komisionit të Zakonshëm | Drejtoria e Shërbimit Social | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2024 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Drejtoria e Shërbimit Social |

# 4. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

## *4.1 Qëllimi*

Proceset mbështetëse janë procese që ofrojnë mbështetje për proceset kryesore. Proceset mbështetëse duhet të gjenden brenda ose jashtë institucionit. Në shembullin e kopshtit, një proces mbështetës mund të jetë rekrutimi i mësuesve ose stafit mbështetës apo transporti i fëmijëve për në kopsht.

Planet e përmirësimit të shërbimit kanë si qëllim ofrimin e shërbimit sa më efikas të kopshteve në aspektin e edukimit të fëmijëve, sigurisë së tyre, zhvillimit të tyre dhe sigurimin e aksesueshmërisë së shërbimit nga të gjithë. Plani fokusohet në trajnimin e stafit të kopshteve, përmirësimin e godinave të kopshteve dhe rritjen e akesueshmërisë dhe arritjes së kopshtit nga të gjithë fëmijët.

## *4.2 Objektiva të përgjithshëm*

Objektivi kryesor i planeve të përmirësimit të shërbimit në lidhje me Proceset Mbështetëse është arritja e standardeve të vendosura nga aktet ligjore përsa i përket numrit të stafit të kopshteve, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së godinave, llojet e materialeve didaktike, cilësinë e ushqimit dhe sigurimin e aksesit në kopsht.

## 4.3 Burimet Njerëzore

### 4.3.1 Rekrutimi i stafit

*Informacion i përgjithshëm*

Kopshtet publike në Bashkinë Mirditë që ndodhen brenda godinave të shkollave administrohen nga drejtorët e shkollave. Janë 15 kopshte që ndodhen në godinat e shkollave, ndërsa pjesa tjetër përkatësisht 2 prej tyre janë godinë më vete dhe janë dy kopshtet publike të njësisë qëndrore.

*Objektiva kryesore:*

Plotësimi i standardeve bazuar në aktet ligjore për stafin e kopshtit për fëmijë.

*Nën-objektivat:*

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | Punësimi i drejtorëve të kopshteve për standardin 1 drejtor për 5 grupe |

*Lista e Aksioneve*

| Numri | Projekti | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxhet Vit 2024 | Buxhet Vit 2025 | Buxhet Vit 2026 | Total periudhe |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 023 | Zbatimi i Udhëzimit Nr. 14 për punësimin e drejtorëve për kopshtet për 5 grupe fëmijësh. | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 60.000 | 60.000 | 60.000 | 180.000 |

*Lista e projekteve*

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 023 | **Projekti**: Zbatimi i Udhëzimit Nr. 14 për punësimin e drejtorëve për kopshtet për 5 grupe fëmijësh. | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Kopshtet që ndodhen brenda godinave të shkollave administrohen nga drejtorët e shkollave. Janë 15 kopshte që ndodhen në godinat e shkollave të shpërndara në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Mirditë. | | |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje | | |
| Kalimi i menaxhimit të arsimit parashkollor nga pushteti qëndror në atë lokal ka sjellë që drejtuesit e kopshteve të raportojnë tek Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës te Bashkia. Kjo njësi administron kopshtet dhe çdo gjë që lidhet me to, si psh: punësimin e Drejtuesve të kopshteve dhe mësueseve. Megjithatë, drejtuesit e shkollave që njëkohësisht menaxhojnë edhe kopshtet, drejtohen nga ZVAP dhe raportojnë aty. Nuk është e qartë nëse drejtuesit e shkollave që menaxhojnë dhe kopshtet, raportojnë te Agjencia e Shërbimit Social | | |

Arsimit dhe Kulturës kur është e nevojshme dhe nuk është e qartë as mënyra se si raportojnë, duke qenë se nuk janë në varësi të kësaj njësie.

Për këtë arsye, është e nevojshme që të zbatohet Udhëzimi nr. 14/2023, në të cilin specifikohet se:

1. Kopshtet me ushqim ose pa ushqim që kanë të paktën 4 grupe të veçanta ose të përziera të kenë një drejtues të institucionit arsimor;
2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kopshtet që veprimtarinë e tyre e zhvillojnë pranë shkollave 9-vjeçare, mund të emërojnë një drejtues kopshti për jo më pak se 5 grupe nxënësish.

**ii Synimi i projektit**

Duke vendosur një drejtues për 5 grupe fëmijësh në kopshte, i cili raporton në Njësinë e Arsimit Parashkollor dhe ka si detyrë të vetme menaxhimin e kopshteve, synohet:

1. Menaxhimi më efikas i kopshteve;
2. Nevojat dhe problemet e kopshteve adresohen në kohën e duhur dhe institucionin e duhur, duke marrë zgjidhje më shpejt;
3. Lehtësimi i procesit të edukimit, sepse mësueset do të fokusohen vetëm në edukimin dhe menaxhimin e klasës së tyre.

**iii Niveli i ndërhyrjes**
**A: Ligjore**

1. Propozimi në KB për zbatimin e Udhëzimit nr. 14/2023;
2. Miratimi i buxhetit për punësimin e drejtuesve të kopshteve;
3. Nxjerrja e një Urdhëri nga Kryetari i Bashkisë për zbatimin e Udhëzimit nr. 14/2023 dhe udhëzime specifike në rastin kur për shkak të infrastrukturës apo transportit nuk mund të realizohet udhëzimi 1 drejtues për 5 grupe.

**B: Menaxheriale**

1. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës harton planin për punësimin e drejtuesve të rinj: sa drejtues duhen dhe cilët kopshte do të menaxhojnë;
2. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës i paraqet KB planin;
3. Pas miratimit të planit nga KB dhe nxjerrjes së Urdhërit nga Kryetari i Bashkisë për punësimin e Drejtuesve fillon procedura e punësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

Një mënyrë për organizimin e kopshteve me drejtues të rinj është:

- Vendosja e një edukatoreje në rolin e Drejtorit për kopshtet. Kështu për të mos u larguar nga kopshtet, edukatorja mund ta përmbushë lehtë këtë funksion

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Hartimi i planit dhe buxhetit të punësimit të drejtuesve (sa drejtues, për cilat kopshte dhe kur do punësohen);
2. Propozimi dhe miratimi në KB;
3. Punësimi i drejtuesve të rinj në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore. Buxheti për punësimin e 3 drejtuesve të rinj në vitin 2024 do të jetë 2,160. Paga për 1 drejtues kopshti është supozuar 60 mijë lekë.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Menaxhimi efikas i kopshteve;
2. Zgjidhja më e shpejtë e problemeve që mund të ketë çdo kopsht;
3. Procesi i nxënies së fëmijëve më efikas.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës,<br>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore. | |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Hartimi i planit dhe buxhetit të punësimit të drejtuesve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Propozimi dhe miratimi në KB | Agjencia e Shërbimit Social | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Arsimit dhe Kulturës | | | | | |
| 3 | Punësimi i drejtuesve të rinj në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 60.000 | 60.000 | 60.000 | 180.000 |
| | | | | 60.000 | 60.000 | 60.000 | 180.000 |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit: 2025** | **g) Ndjek zbatimin e projektit:** Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

*Risqet*

| **Risku** | **Mitigimi** |
|---|---|
| Bashkia mund të mos ketë fonde të mjaftueshme për të financuar punësimin e drejtuesve të kopshteve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës do të lobojë në KB për miratimin e buxhetit për punësimin e drejtuesve të kopshteve ose do të shihet mundësia për financim nga donatorë të ndryshëm |

### 4.3.2 Trajnimi i stafit

*Informacion i përgjithshëm*

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) ka si përgjegjësi rritjen e kapaciteteve të stafit të IA nëpërmjet trajnimeve të detyrueshme. Për mësuesit e arsimit parashkollor janë 3 trajnime vjetore të detyruara. Nga analiza e situatës së arsimit parashkollor në Bashkinë Mirditë, nuk dihet nëse këto trajnime kryhen dhe nëse edukatoret marrin pjesë dhe njoftohen paraprakisht.

Gjithashtu, kopshtet e Bashkisë Mirditë nuk kanë dalje emergjence dhe stafi nukështëi përgatitur për mënyrën e reagimit në rastin e situatave emergjente, përfshirë këtu edhe kur mund të jetë e nevojshme dhënia e ndihmës së parë. Për këto arsye është e nevojshme rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve.

*Objektiva kryesore:*

Rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve

*Nën-objektivat:*

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | Kryerja e trajnimeve vjetore akredituese të stafit të kopshteve nga ASCAP |
| 2 | Trajnimi i stafit të kopshteve për rastet e emergjencave, ndihmën e parë, përdorimin e internetit, microsoft office, etj. |

*Lista e Aksioneve*

| Numri | Projekti | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxhet Vit 2024 | Buxhet Vit 2025 | Buxhet Vit 2026 | Total periudhe |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 025 | Rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 60000 | 60000 | 60000 | 180000 |
| 024 | Hartimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me ASCAP | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |

*Lista e projekteve*

| | | |
|---|---|---|
| **Nr.** 024 | **Projekti**: Hartimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me ASCAP | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) ka si përgjegjësi rritjen e kapaciteteve të stafit të IA nëpërmjet trajnimeve të detyrueshme. Për mësuesit e arsimit parashkollor janë 3 trajnime vjetore të detyruara. Nga analiza e situatës së arsimit parashkollor në Bashkinë Mirditë, nuk dihet nëse këto trajnime zhvillohen dhe nëse mësuesit marrin pjesë. | | |

| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje | |
|---|---|
| Për këtë arsye është e nevojshme të hartohet një marrëveshje bashkëpunimi mes Bashkisë dhe ASCAP dhe ZVAP në mënyrë që në çdo rast mësueset të mos kryejnë trajnime me pagesë në institucione të tjera jo publike. | |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>Nëpërmjet marrëveshjes së bashkëpunimit Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës do të pajiset çdo vit me kalendarin e trajnimeve dhe do ta dërgojë atë në çdo IA, në mënyrë që gjithë stafi të jetë në dijeni për kohën dhe vendndodhjen e trajnimeve. Në këtë mënyrë, trajnimet nuk do kryhen më kundrejt pagesës, por do të kryhen nga ASCAP, kështu do të ketë më shumë siguri edhe për kryerjen e tyre siç duhet dhe jo formalisht. | |
| **iii Niveli i ndërhyrjes**<br>**A: Ligjore**<br><br>1. Hartimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi mes Bashkisë, ASCAP dhe ZVAP.<br><br>**B: Menaxheriale**<br><br>1. Organizimi i një takimi mes përfaqësuesve të Njësisë së Arsimit Parashkollor, ZVAP dhe ASCAP për të diskutuar mbi procedurat e trajnimeve që kryhen dhe çështje të tjera;<br>2. Hartimi i një marrëveshje bashkëpunimi për të siguruar zgjidhjen e problematikave ekzistuese;<br>3. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës merr nga ASCAP kalendarin e trajnimeve (jo vetëm të detyrueshmet), broshura të hartuara nga ASCAP dhe ua dërgon kopshteve ose institucioneve përgjegjëse. | |
| **iv Aktivitetet kryesore të projektit**<br><br>1. Organizimi i takimit mes përfaqësuesve të Njësisë së Arsimit Parashkollor, ZVAP dhe ASCAP;<br>2. Hartimi dhe firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit. | |
| **b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**<br><br>1. Kryerja e trajnimeve akredituese të stafit të IA;<br>2. Rritja e kapaciteteve të stafit të IA. | |
| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |

| | |
|---|---|
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës;<br>• Drejtoria e Shërbimit Social. | • ZVAP<br>• ASCAP |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Takim mes Njësisë së Arsimit Parashkollor, ZVAP dhe ASCAP | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Hartimi dhe firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2025 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 025 | **Projekti**: Rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |

**a)Përshkrim i shkurtër i projektit**

**i Situata**

Kopshtet e Bashkisë Mirditë nuk kanë dalje emergjence dhe stafi nukështëi përgatitur për mënyrën e reagimit në rastin e situatave emergjente, përfshirë këtu edhe kur mund të jetë e nevojshme dhënia e ndihmës së parë.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Një nga nevojat e Bashkisë Mirditë është rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve. Është e nevojshme që të kryhen trajnime nga Bashkia Mirditë për stafin e IA për temat:

1. Ndihma e parë;
2. Reagimi në situata rreziku të godinave;

**ii Synimi i projektit**

Ky projekt synon rritjen e kapacitetit të stafit të kopshteve përsa i përket ndihmës së parë dhe reagimit në situata emergjente.

**iii Niveli i ndërhyrjes**

**A: Menaxheriale**

1. Organizimi i trajnimeve për stafin e kopshteve (për çdo rajon të qytetit të Mirditës dhe për çdo Njësi Administrative) mbi ndihmën e parë dhe reagimin në raste rreziku.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Organizimi i trajnimeve për stafin e IA.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Ritje e kapacitetit të stafit të IA;
2. Shmangia e situatave të rrezikut dhe mbrojtja fizike e fëmijëve.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës;<br>• Shërbimi Zjarrfikës Mirditë. | • OJF, |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Organizimi i trajnimeve për stafin e IA | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | | | | |
| | | | | | | | |

| f) Periudha e zbatimit: | g) Ndjek zbatimin e projektit: |
|---|---|
| 2024 | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

## 4.4 Menaxhimi i godinave

### 4.4.1 Rikonstruksioni i objekteve

*Informacion i përgjithshëm*

Sipas VKM nr. 408, dt 15/05/2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",* neni 34 pika 5, distancat e ndërtimeve të ndryshme nga çerdhet, kopshtet, shkollat dhe objektet shëndetësore duhet të jenë në drejtimin jug, jo më pak se 1,5 herë e lartësisë së përgjithshme të ndërtimit më të lartë të shprehur në metra. Duke qenë se kopshtet dhe shkollat janë institucione të pavarura nga njëra-tjetra, atëherë sipas **VKM nr. 408** duhet të ketë një distancë mes tyre, por pjesa më e madhe e kopshteve publike në territorin e Bashkisë Mirditë ndodhen brenda godinave të shkollave. Nga 17 kopshte publike në total, vetëm 2 prej tyre janë në godinë më vete. Pjesa tjetër e kopshteve publike, janë akomoduar brenda godinave të shkollave.

Pavarsisht faktit se një pjesë e kopshteve ndodhen Brenda godinave të shkollave, duhet theksuar fakti se disa prej këtyre shkollave nuk funksionojnë. Kështu 5 kopshte, Tarazh, Vaushkjezë, Prosek, Bardhaj dhe Shëngjin ndodhen Brenda godinave të shkollave jo funksionale.

Për këto kopshte, Bashkia Mirditë, ka planifikuar që në të ardhmen të bëhet veçimi i godinave të kopshteve, nga godinat e shkollave, në mënyrë që fëmijëve tu krijohen kushtet e pështatshme, tualete më vete, oborr më vete, infrastrukturë sipas standardeve. Radhë prioriteti lidhur me këtë ndërhyrje kanë kopshtet:

- Reps
- Rrasfik
- Domgjon
- Malaj
- Perlat Qendër
- Kaçinar
- Klos

Ndërkohë një pjesë e godinave janë tepër të vjetra:

- 15 prej tyre janë ndërtuar gjatë viteve 1951-1991;
- 2 kopshte janë ndërtuar gjatë viteve 1991-2000;

Nevojat e kopshteve janë si më poshtë:

- Rikonstruksion tualeti**:** 17 kopshte, 100% kanë raportuar se kanë nevojë për rikonstruksion tualeti.
- Rikonstruksion i ambjentit të brendshëm: 10 kopshte kanë raportuar se kanë nevojë për rikonstruksion/rinovim të ambjenti të jashtëm.
- Lyerje: 11 kopshte kanë raportuar se kanë nevojë për lyerje.
- Furnizim me ujë të pijshëm: Në Reps mungon uji i pijshëm në kopshte, ndërsa 12 kopshte kanë sistem hidraulik jo plotësisht funksional.

*Objektiva kryesore:*

Rikonstruksioni i godinave duke iu përmbajtur standardeve për hapësirat e kopshteve dhe facilitetet e nevojshme

*Nën-objektivat:*

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | Rikonstruksioni i godinave të kopshteve të cilat kanë nevojë për rikonstruksion |
| 2 | Ofrimi i ujit të pijshëm në kopshtet ku mungon (Reps) |

*Lista e projekteve*

| **Nr.** 026 | **Projekti**: Furnizimi me ujë të pijshëm në kopshtet ku mungon (Reps) | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |
|---|---|---|
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Nga analiza e situatës së arsimit parashkollor në Bashkinë Mirditë rezultoi se një pjesë e kopshteve nuk furnizohen me ujë të pijshëm. Të gjitha kopshtet furnizohen me ujë, por jo në të gjitha kopshtet uji është i pijshëm. Në fshatin Reps të Njësisë Administrative Orosh, ka mungesë të ujit të pijshëm dhe nuk ka një mënyrë se si mund të sigurohet uji në kopshte. | | |

| |
|---|
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje |
| Sipas *“Standarde për Projektimin e Kopshteve”*, miratuar me Urdhërin nr. 159, datë 01.03.2017 në kopshte:<br><br>1. Duhet të sigurohet furnizimi me ujë të rrjedhshëm dhe me cilësi;<br>2. “Ujë i pijshëm”, praktikisht njihet dhe rekomandohet vetëm uji i ambalazhuar dhe i konfeksionuar i cili përpunohet mbi bazë të kërkesave përkatëse specifike të vetive fiziko-kimike e bakteriologjike ndërsa uji për përdorim hidrosanitar konsiderohet uji i cili përpunohet në shkallë më të reduktuar se uji i pijshëm për arsye kostoje prodhimi, për shkak të higjenës së rrjetit shpërndarës dhe depozitave etj. Ky ujë, përgjithësisht ujë për përdorim publik, plotëson kushtet e përdorimit human, kryesisht për përdorim hidro-sanitar, por gjithashtu është i padëmshëm për shëndetin i cili gjerësisht përdoret për qëllime të ndryshme higjenosaitare, për higjenën e gojës, për përdorime në kuzhina – gatime, larje etj si dhe nuk është ujë i dëmshëm dhe në rastet kur përdoret për pirje, ndonëse nuk rekomandohet si i tillë përveçse ujit të ambalazhuar. |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>Për të ofruar ujë të rrjedhshëm dhe me cilësi është e nevojshme që çdo kopsht të pajiset me filtra uji për të kthyer ujin e rrjedhshëm në ujë të pijshëm. |
| **iii Niveli i ndërhyrjes**<br>**A: Ligjore**<br><br>1. Miratimi në KB i buxhetit për pajisjen e çdo kopshti me filtra uji<br><br>**B: Menaxheriale**<br><br>1. Përgatitja e planit të pajisjes së çdo kopshti me filtra uji nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës dhe Qendra Ekonomike. Plani do të përmbajë numrin e kopshteve që do të pajisen dhe koston totale;<br>2. Hapja e procedurës së prokurimit publik për pajisjen e çdo kopshti me filtra uji. Filtrat e ujit do duhet të ndryshohen çdo vit, ndaj kjo procedurë do të kryhet çdo vit;<br>3. Përzgjedhja e operatorit ekonomik, firmosja e kontratës dhe pajisja e kopshteve me filtra uji;<br>4. Urdhër nga Bashkia drejt Inspektoriatit Vendor për kryerjen e analizave të ujit pas vendosjes së filtrave, bazuar në Ligjin Nr. 10433, datë 16.06.2011, *“Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”,* neni 19, pika 5.<br>5. Kryerja e analizave të ujit pas vendosjes së filtrave nga AKU. Analizat do të kryhen për të siguruar se uji i filtruar është i shëndetshëm dhe mund të konsumohet. |

| |
|---|
| **C: Infrastrukturore**<br><br>1. Vendosja e filtrave të ujit nga operatori ekonomik.<br>2. Vendosja e një depozite uji. |
| **iv Aktivitetet kryesore të projektit**<br><br>1. Hartimi i planit të pajisjes së kopshteve me filtra uji;<br>2. Miratimi i planit në KB;<br>3. Hapja e procedurës së prokurimit publik;<br>4. Përzgjedhja e operatorit ekonomik dhe pajisja e kopshteve me filtra uji;<br>5. Kryerja e analizave të ujit pas vendosjes së filtrave nga teknologu ushqimor i Njësisë së Arsimit Parashkollor ose Instituti i Shëndetit Publik Mirditë. |
| **b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**<br><br>1. Të gjithë kopshtet do të kenë ujë të pijshëm. |

| | |
|---|---|
| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)<br><br>• Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës;<br>• Qendra Ekonomike;<br>• Njësia e Prokurimit Publik. | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)<br><br>• Operatori Ekonomik |
| | |
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2024 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 027 | **Projekti**: Rikonstruksion i Kopshtit Reps | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata** | | |

| |
|---|
| Gjatë analizës së situatës së arsimit parashkollor në Bashkinë Mirditë ka rezultuar se Kopshti Repska nevojë për rikonstruksion. |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje |
| VKM nr. 159, datë 01.03.2017, *"Për miratimin e standardeve të projektimit të kopshteve"*, ka për qëllim që të shërbejë si referencë për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, programimit, projektimit/dizajnit dhe ndërtimit të ndërtesave/hapësirave të reja të kopshteve apo në rehabilitimin e ndërtesave ekzistuese. Në të paraqiten standarded për godinat e kopshteve në rast se duhet të ndërtohen të reja ose të rikonstruktohen. |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>Ky projekt synon përmirësimin e infrastrukturës së godinës së Kopshti Reps, bazuar në Standarded e VKM Nr. 159. |
| **iii Niveli i ndërhyrjes**<br>**A: Ligjore**<br><br>1. Miratimi i buxhetit për përmirësimin e infrastrukturës së Kopshtit Reps në KB.<br><br>**B: Menaxheriale**<br><br>1. Përgatitja e planit të përmirësimit të infrastrukturës së Kopshtit Reps nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;<br>2. Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik për gjetjen e operatorit ekonomik për ndërhyrjet në Kopshtin X. Gjetja e operatorit dhe firmosja e kontratës;<br>3. Supervizimi i punimeve në Kopshtin Reps<br>4. Kolaudimi i Kopshtit Reps<br><br>**C: Infrastrukturore**<br><br>1. Përmirësimi i infrastrukturës së Kopshtit Reps nga operatori ekonomik. |
| **iv Aktivitetet kryesore të projektit**<br><br>1. Përgatitja e planit të përmirësimit të infrastrukturës së Kopshtit Reps;<br>2. Miratimi i buxhetit në KB;<br>3. Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik dhe gjetja e operatorit ekonomik: |

4. Përmirësimi i infrastrukturës së Kopshtit Reps.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Kushte infrastrukturore të përshtatshme në kopshtet e Bashkisë Mirditë në përshtatje me VKM Nr. 159.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit<br>• Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës<br>• Njësia e Prokurimit Publik | • Operatori ekonomik. |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| **Nr** | **Emertimi** | **Pergjegjes** | **Fakt Aktual** | **Buxheti Viti 2024** | **Buxheti Viti 2025** | **Buxheti Viti 2026** | **Total** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Përgatitja e planit të përmirësimit të infrastrukturës së Kopshtit Reps | Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit | | | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Miratimi i buxhetit në KB | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik dhe gjetja e operatorit ekonomik | Njësia e Prokurimit Publik | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Përmirësimi i infrastrukturës së Kopshtit Reps | Operatori Ekonomik | | | 700000 | | 700000 |
| | | | | | | | |

| f) Periudha e zbatimit: | g) Ndjek zbatimin e projektit: |
|---|---|
| 2025 | Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit |

## 4.5 Materialet

### 4.5.1 Planifikimi i nevojës për materiale

*Informacion i përgjithshëm*

Drejtueset e kopshteve kanë raportuar nëse kopshtet disponojnë materiale didaktike për çdo fëmijë dhe 17 prej tyre kanë raportuar negativisht. Kopshte që nuk disponojnë materiale didaktike për çdo fëmijë ndodhen në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Mirditë. Shpenzimet për materiale didaktike mbulohen nga prindërit, ndaj jo të gjitha kopshtet kanë materiale didaktike për çdo fëmijë sepse jo të gjithë prindërit pranojnë të paguajnë për to. Bashkia nuk i pajis kopshtet me materiale didaktike, ajo mbulon vetëm shpenzimet për materiale kancelarike.

*Objektiva kryesore:*

Sigurimi i materialeve të nevojshme didaktike dhe kancelarike për të për të siguruar zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve, bazuar në “Standartet e Zhvillimit dhe të të Nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç”.

*Nën-objektivat:*

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | Hartimi i një liste të unifikuar të materialeve didaktike për të siguruar zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve, bazuar në “Standartet e Zhvillimit dhe të të Nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç” |

*Lista e projekteve*

<table>
<tr><td>Nr. 028</td><td>Projekti: Unifikimi i listës së materialeve didaktike për të gjithë kopshtet e Bashkisë Mirditë</td><td>Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>Funksioni: 09</td></tr>
<tr><td colspan="3">a)Përshkrim i shkurtër i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="3">i Situata<br><br>Materialet didaktike janë financuar nga kontributi vullnetar i prindërve. Jo të gjitha kopshtet kanë material didaktike pasi jo të gjithë prindërit pranojnë të paguajnë për to.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kopshtet e të gjitha Njësive Administrative, kanë shprehur një nevojë të theksuar për materiale didaktike.<br><br>Megjithatë, është e nevojshme që të ngrihet një grup pune për të vlerësuar listën e materialeve. Duhet vlerësuar cilësia e materialeve, sasia e tyre dhe a janë të mjaftueshme për të zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve, bazuar në “Standartet e Zhvillimit dhe të të Nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç”.</td></tr>
<tr><td colspan="3">ii Synimi i projektit<br><br>Materialet didaktike dhe kancelarike janë të domosdoshme në formimin dhe të nxënit e fëmijëve. Për këtë arsye është e nevojshme të ofrohen në sasinë e duhur dhe në cilësinë e duhur. Nëpërmjet këtij projekti synohet të ngrihet një Grup Pune nga Bashkia Mirditë me pjesëmarrje nga mësuesit e kopshteve, punonjës të Bashkisë përgjegjës për arsimin parashkollor, Shërbimet Sociale dhe ZVAP, për të vlerësuar listën e materialeve didaktike, për të krijuar një listë të unifikuar për të gjithë kopshtet dhe të mjaftueshme për procesin e zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve.</td></tr>
<tr><td colspan="3">iii Niveli i ndërhyrjes<br><br>A: Menaxheriale<br><br>1. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës organizon takimin mes mësuesve të kopshteve, Shërbimit Social dhe Qendrës Ekonomike për të vlerësuar dhe përmirësuar listën e materialeve didaktike;</td></tr>
</table>

2. Krijohet një listë e unifikuar dhe e qartë. Lista përmban emrin e materialit, sasinë e nevojshme për fëmijë, markën dhe çmimin;
3. Hapet procedura e prokurimit publik për blerjen e materialeve nga Njësia e Prokurimit Publik;
4. Materialet shpërndahen në kopshte bazuar te numri i fëmijëve nga Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës, pasi ka konfirmuar me kopshtin numrin e fëmijëve dhe moshën e tyre.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Ngritja e grupit të punës;
2. Unifikimi dhe përmirësimi i listës;
3. Blerja e materialeve. Kostoja për 1 fëmijë/vit është supozuar 5 mijë lekë.
4. Shpërndarja në kopshte.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Përmirësimi i mjeteve të kopshtit;
2. Furnizimi në mënyrë të vazhdueshme i kopshteve, me materiale që ndihmojnë në zhvillimin e programit;
3. Përpilimi i një liste finale me të gjitha mjetet që duhet të ketë kopshti dhe çdo fëmijë.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës<br>• Drejtoria e Shërbimit Social<br>• Njësia e Prokurimit Publik<br>• Qendra Ekonomike | |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ngritja e grupit të punës | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Unifikimi dhe përmirësimi i listës | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | | | | |
| 3 | Blerja e materialeve | Njësia e Prokurimit Publik / Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | | | | |
| 4 | Shpërndarja në kopshte | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:**<br>2025 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:**<br>Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

## 4.6 Ushqimi

### 4.6.1 Planifikimi i dietës dhe menysë

*Informacion i përgjithshëm*

Kopshtet publike që ofrojnë ushqim në territorin e Bashkisë Mirditë janë 2 në total. Kopshtet zbatojnë urdhërin e MSHMS për menunë ushqimore. Të dy kopshtet me drekë ndodhen në qytetin e Mirditës në Njësinë Administrative Rrëshen dhe Rubik. Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet me drekë është **175 fëmijë,** kjo e dhënë nënkupton faktin se një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve janë të regjistruar në kopshte me drekë, pavarësisht se numri i kopshteve me drekë është më i vogël se numri i kopshteve pa drekë.

*Objektiva kryesore:*

Mbulimi efikas i shërbimit të ofrimit të ushqimit dhe fjetjes në kopshte

*Nën-objektivat:*

| Nr | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | Plotësimi i kërkesës për shërbimin e drekës në qytetin e Mirditës |

*Lista e projekteve*

| | | |
|---|---|---|
| **Nr**. 029 | **Projekti**: Hapja e një kopshti të ri me drekë në Reps në NjA Orosh | **Programi Buxhetor:** 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor<br><br>**Funksioni:** 09 |
| **a)Përshkrim i shkurtër i projektit** | | |
| **i Situata**<br><br>Kopshtet të cilët ofrojnë shërbimin e drekës ndodhen vetëm në njësitë Rrëshen dhe Rubik. Nga 17 kopshte, 2 prej tyre janë me drekë dhe 15 prej tyre nuk e ofrojnë këtë shërbim. Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet me drekë është 175 fëmijë. Ndërsa, numri i fëmijëve të regjistruar në total në kopshtet e qytetit të Mirditës është 401. Kjo e dhënë nënkupton faktin se | | |

| |
|---|
| një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve janë të regjistruar në kopshte me drekë, pavarësisht se numri i kopshteve me drekë është më i vogël se numri i kopshteve pa drekë. |
| Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje |
| Sipas të dhënave të marra nga Bashkia Mirditë dhe nga raporti analitik i arsimit parashkollor në Bashkinë e Mirditës rezulton se kërkesa për shërbimin e drekës në kopshte është më e lartë se oferta. Kjo është një nga arsyet e mbipopullimit të kopshteve me drekë. Për këtë arsye, është e nevojshme hapja e një kopshti të ri me drekë në Reps pasi edhe numri i fëmijëve në këtë zonë është i konsiderueshëm dhe kërkesat kanë qenë të shumta. Hapja e një kopshti në këtë zonë, do ti vinte në ndihmë shumë familjeve të cilët si pasojë e mungesës së një kopshti me ushqim, detyrohen të shkojnë drejt Rrëshenit dhe Rubikut për të regjistruar fëmijët e tyre. |
| **ii Synimi i projektit**<br><br>Duke hapur një kopësht të ri me drekësynohet që të ulet mbipopullimi i kopshteve me drekë dhe të plotësohet kërkesa e lartë për këtë shërbim. |
| **iii Niveli i ndërhyrjes**<br>**A: Ligjore**<br><br>1. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës së bashku me Qendrën Ekonomike përcaktojnë kostot e hapjes së një kopshti me drekë;<br>2. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës propozon në KB hapjen e një kopshti me drekë.<br>3. KB miraton buxhetin për hapjen e një kopshti me drekë.<br><br>**B: Menaxheriale**<br><br>1. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore punëson 1 kuzhiniere dhe 4 mësues ndihmës që do të jenë prezent gjatë kohës së shërbimit të vakteve;<br>2. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës ndryshon kontratën me Operatorin Ekonomik që furnizon kopshtet me ushqim, duke shtuar 1 kopsht të ri në kontratë.<br><br>**C: Infrastrukturore**<br><br>1. Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit përcaktojnë kopshtin në qytetin e Mirditës që mund të kthehet në kopsht me drekë, duke u nisur nga:<br>o Infrastruktura e kopshtit<br>o Vendndodhja e kopshtit |

- Numri i banorëve në atë zonë dhe numri i fëmijëve në moshë kopshti

2. Fillon përshtatja e kopshtit pa drekë në kopsht me drekë:
    - Përgatitet ambienti i kuzhinës
    - Përgatitet ambienti i konsumimit të ushqimit

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Përcaktimi i kostove të shtimit të një kopshti me drekë;
2. Përcaktimi i kopshtit që do të hapet me drekë;
3. Miratimi në KB;
4. Punësimi i burimeve njerëzore të nevojshëm;

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Plotësimi i kërkesës për shërbimin e ushqimit në kopshte;
2. Ulja e mbipopullimit në kopshtet me drekë;
3. Rritja e regjistrimit të fëmijëve në kopshtet publike të qytetit të Mirditës.

| Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) | Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) |
|---|---|
| • Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës<br>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore<br>• Qendra Ekonomike<br>• Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit | • OJF,<br>• Donatorë. |

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

| Nr | Emertimi | Pergjegjes | Fakt Aktual | Buxheti Viti 2024 | Buxheti Viti 2025 | Buxheti Viti 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Përcaktimi i kostove të hapjes së një kopshti me drekë | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës / Qendra Ekonomike | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Përcaktimi i zonës që do të hapet kopshti me | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës / Drejtoria e Planifikimit dhe | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | drekë | Zhvillimit të Territorit | | | | | |
| 3 | Miratimi në KB | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Punësimi i Burimeve Njerëzore të nevojshme | Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës / Drejtoria e Burimeve Njerëzore | | | | | |
| | | | | | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit:** 2026 | **g) Ndjek zbatimin e projektit:** Agjencia e Shërbimit Social Arsimit dhe Kulturës |

| | |
|---|---|
| Nr.30 | **Projekti**: Vendosja e sistemit të kamerave në kopshtet Rrëshen dhe Rubik |

## 5. Buxheti

Në tabelën e mëposhtme paraqitet buxheti **shtesë** (në mijë lekë) që do t'i nevojitej bashkisë nëse do të implementonte gjithë projektet që përmban Plani i Përmirësit të Shërbimit

| Programi Buxhetor | Buxhet 2024 | Buxhet 2025 | Buxhet 2026 | TOTAL |
|---|---|---|---|---|
| 09120 – Arsimi Bazë përfshirë arsimin parashkollor | 163,205.0 | 163,205.0 | | |
| 10430 – Kujdesi social për familjet dhe fëmijët | | | | |
| 10140 - Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara | | | | |

| | TOTAL | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

| Kategoria | Zinxhiri | Procesi | Projekti | Fakt Aktual | Buxhet Vit 2024 | Buxhet Vit 2025 | Buxhet Vit 2026 | Total periudhe |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Proceset Mbështetëse | Materialet | Planifikimi i nevojës për materiale | Unifikimi i listës së materialeve didaktike për të gjithë kopshtet e Bashkisë Mirditë | | | 500000 | 500000 | 1000000 |
| Proceset Mbështetëse | Menaxhimi i godinave | Rikonstruksioni i objekteve | Rikonstruksion i Kopshtit Reps | | 700000 | | | 700000 |
| Proceset Mbështetëse | Menaxhimi i godinave | Rikonstruksioni i objekteve | Furnizimi me ujë të pijshëm në kopshtet ku mungon | | 900000 | 1200000 | 5000000 | 7100000 |
| Proceset Mbështetëse | Ushqimi | Planifikimi i dietës dhe menysë | Hapja e një kopshti të ri me drekë në Reps, NjA Orosh | | | | 1500000 | 1500000 |
| Proceset Mbështetëse | Burimet Njerëzore | Trajnimi i stafit | Rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Proceset Mbështetëse | Burimet Njerëzore | Trajnimi i stafit | Hartimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me ASCAP | | | | | |
| Proceset Mbështetëse | Burimet Njerëzore | Rekrutimi i stafit | Zbatimi i Udhëzimit Nr. 14 për punësimin e drejtorëve për | | 60.000 | 60.000 | 60.000 | 180.000 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | kopshtet për 5 grupe fëmijësh. | | | | | |
| Proceset Kryesore | Fëmijët me aftësi të kufizuar | Kërkesa për fonde shtesë | Vendosja e rampave dhe respektimi i standardeve për infrastruktu rën e fëmijëve me AK pranë institucione ve arsimore | | 3000 0 | 30000 | 30000 | 90000 |
| Proceset Kryesore | Fëmijët me aftësi të kufizuar | Ndihma e përditshme | Ngritja e Komisionit të Zakonshëm pranë kopshteve | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Proceset Kryesore | Fëmijët me aftësi të kufizuar | Adresimi i prindërve | Përmirësim i i procesit të diagnostiki mit të fëmijëve me AK përmes mbështetjes psiko-sociale të prindërve dhe mësuesve | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Proceset Kryesore | Mbrojtja e fëmijëve | Shërbimi bashkiak i mbrojtjes së fëmijës | Promovimi i rolit dhe detyrave te PMF | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Proceset Kryesore | Mbrojtja e fëmijëve | Identifikimi i abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës | Hartimi i një dokumenti mbi politikat e mbrojtjes | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | së fëmijëve përshtatur me gjuhën e kuptueshme për fëmijët e kopshteve dhe stafeve pedagogjike ne kopshte | | | | | |
| Proceset Kryesore | Mbrojtja e fëmijëve | Identifikimi i abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës | Vendosja dhe promovimi i një punonjësi të dedikuar në çdo institucion të arsimit parashkollor i cili do të kujdeset për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucion | | | | | |
| Proceset Kryesore | Mbrojtja e fëmijëve | Identifikimi i abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës | Shtimi i një psikologu në Njësinë e Arsimit Parashkollor pranë ASHSK | | 489.6 | 489.6 | 489.6 | 1467 |
| Proceset Kryesore | Përfshirja sociale | Ndihma e përditshme | Ofrimi i paketave lehtësuese për fëmijët në nevojë | | | | | |
| Proceset Kryesore | Përfshirja sociale | Identifikimi i nevojave | Ngritja e skuadrave të terrenit | | | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për përfshirje | për identifikimin në mënyrë proaktive të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale në komunitet dhe fëmijëve në situatë rruge | | | | | |
| Proceset Kryesore | Përfshirja sociale | Identifikimi i nevojave për përfshirje | Ngritja e NJVNR në Rrëshen dhe Rubik | | | | | |
| Procesi i Menaxhimit | Organizmat e Institucionit Arsimor | Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit | Fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Procesi i Menaxhimit | Organizmat e Institucionit Arsimor | Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit | Ngritja i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Procesi i Menaxhimit | Organizmat e Institucionit Arsimor | Bordi i Kopshtit | Ngritja e një strukture lidhëse mes Bashkisë dhe kopshteve | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Procesi i Menaxhimit | Organizmat e Institucionit Arsimor | Bordi i Kopshtit | Fuqizimi i Bordit të Kopshtit | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Procesi i Menaxhimit | Organizmat e Institucionit Arsimor | Bordi i Kopshtit | Themelimi i Bordit të Kopshtit | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Procesi i Menaxhimit | Organizmat e Institucionit Arsimor | Këshilli i Prindërve | Fuqizimi i Këshillit të Prindërve | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Procesi i Menaxhimit | Organizmat e Institucionit Arsimor | Këshilli i Prindërve | Themelimi i Këshillit të Prindërve | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Procesi i Menaxhimit | Regjistrimi i fëmijëve | Regjistrimi i fëmijëve në kopsht | Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo Kopsht | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Procesi i Menaxhimit | Regjistrimi i fëmijëve | Regjistrimi i fëmijëve në kopsht | Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Procesi i Menaxhimit | Regjistrimi i fëmijëve | Regjistrimi i fëmijëve në kopsht | Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Procesi i Menaxhimit | Regjistrimi i fëmijëve | Regjistrimi i fëmijëve në kopsht | Krijimi i regjistrit i cili përmban të dhëna analitike për kopshtin | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Procesi i Menaxhimit | Regjistrimi i fëmijëve | Regjistrimi i fëmijëve në kopsht | Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti | | 0 | 0 | 0 | 0 |